

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I SËMUNDJEVE INFEKTIVE DHE DERMATOLOGJISË

VLERËSIMI I DEPRESIONIT/ÇRREGULLIMEVE
KONJITIVE NË INFEKSIONIN HIV/AIDS

Disertacion
Për Marrjen e Gradës Shkencore

DOKTOR

Disertanti

Sadik Aliko

Udhëheqës Shkencor

Prof. Asc. Dr. Luan Mavriqi

TIRANË 2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË



UNIVERSITETI I MJEKESISE, TIRANE

DISERTACION
I PARAQITUR NGA
Z. Sadik ALIKO

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

SPECIALITETI: INFEKTOLOGJI

TEMA: “VLERËSIMI I DEPRESIONIT/ÇRREGULLIMEVE KONJITIVE NE INFEKSIONIN HIV/AIDS”

MBROHET NË DATË: 14.02.2023 PARA JURISË:

- | | |
|-------------------------------|------------------|
| 1. Prof. Dr. Pëllumb PIPERO | KRYETAR |
| 2. Prof. Dr. Arjan HARXHI | ANËTAR (OPONENT) |
| 3. Prof. Dr. Krenar PREZA | ANËTAR (OPONENT) |
| 4. Prof. Dr. Ariel ÇOMO | ANËTAR |
| 5. Prof. Dr. Adriana BABAMETO | ANËTAR |

Parathënie

Çrregullimet klinike depresive ndodhin shumë më rrallë në pacientët me HIV, në çdo fazë sëmundjeje, sesa besohet në fillim të epidemisë. Kur ndodh, depresioni klinik në kontekstin e sëmundjes nga HIV i përgjigjet trajtimit antidepressiv në të njëjtin ritëm si depresioni klinik te pacientët e shëndetshëm mjekësor - një gjetje inkurajuese, pasi trajtimi i depresionit është një nga historitë e suksesit të psikiatrisë.

Nuk ka asnjë provë që barnat kundër depresionit janë në ndonjë mënyrë të dëmshme për sistemin imunitar. Prandaj, ne i nxisim specialistët e HIV-it që të jenë vigjilentë ndaj shenjave dhe simptomave të depresionit dhe të marrin në konsideratë trajtimin, ose të paktën referimin, kur simptomat vërehen.

Falenderime

Falenderoj Prof. Dr. Arjan Harxhi për ndihmën në të gjitha etapat e studimit dhe udhëheqesin shkencor Prof. Asc. Dr. Luan Mavriqi.

Falenderoj familjen time për mbështetjen dhe kurajon për të përfunduar me sukses këtë projekt shkencor.

Skurtesa

HIV	Human immunodeficiency virus
AIDS	Acquiredimmunodeficiency syndrome
HAND	HIV-associated NeurocognitiveDisorder
HAD	HIV-associated dementia
HPE	HIV-associated progressive encephalopathy
CNS	Central nervous system
HAART	Highly active antiretroviral therapy
ANI	Asymptomatic neurocognitive impairment
MND	Ninor neurocognitive disorder
MSE	Mental Status Examination

Përmbajtja

<i>Parathënie</i>	3
Falenderime.....	4
I HYRJE	10
1.1 Çrregullimet Neurokonjitive të lidhura me HIV (HAND).....	10
1.2 Përcaktimi i depresionit.....	11
1.3 Epidemiologjia	12
2.0 Depresioni, statusi imunitar dhe përparimi i sëmundjes	14
2.1 Faktorët e riskut për Depresion në sëmundjen e HIV-it.....	15
2.1.1 Faktorët e rrezikut lidhur sipas epokës HAART	16
2.2 Fizpatologjia.....	17
2.2.1 Proteinat qelizore.....	17
2.2.2 Proteinat e HIV (virotoksina)	17
2.2.3 Sëmundjet autoimune	18
3.0 Paraqitja Klinike.....	18
3.1 Dinamika virale	19
3.2 Variacioni viral.....	21
4.0 Rënia e numrit të qelizave CD4 dhe përparimi i sëmundjes	21
5.0 Ekzaminim fizik	22
5.1 Kriteret diagnostike	23
5.2 Stadifikimi i Kompleksit të Demencës AIDS	24
5.3 Ekzaminimi neurologjik në pacientët pediatrikë.....	25
5.4 Kriteret për encefalopatinë progresive të lidhur me HIV	25
6.0 Diagnoza diferenciale.....	25
6.1 Sindroma inflamatore e rindërtimit imunitar (IRIS)	26
6.2 Përmbledhje e Zhvillimit.....	27
6.3 Analiza e lëngut cerebrospinal	27
7.0 Neuroimazheria	28
7.1 MRI funksionale.....	29

7.2 Metodat e kërkimit imazherik	29
7.2 Elektroencefalografia	30
7.3 Testimi neuropsikologjik	30
8.0 Antiretroviralët dhe terapi të tjera	31
8.1 Fillimi i trajtimit	33
8.2 Kërkimet për trajtimin	34
9.0 Vlerësimi i përfitimeve të trajtimit	38
10.0 Ndjekja	39
11.0 Kompetenca e pacientit dhe vendimmarrja	39
12.0 Menaxhimi i pacientëve të infektuar me HIV në depresion	40
13.0 Medikamentet psikotrope dhe frenuesit e proteazës	41
14.0 Prognoza	42
15.0 Edukimi i pacientit	42
II METODOLOGJIA	43
2.1 Qëllimi	43
2.2 Objektivat	43
2.3 Materiali dhe Metoda	44
2.4 Metodologjia e analizës statistikore	46
III REZULTATE	47
IV DISKUTIM	67
V PËRFUNDIME	80
VI REKOMANDIME	81
VII SHTOJCA	82
VIII BIBLIOGRAFIA	85

Lista e tabelave

Tabela 3. 1 Karakteristikat sociodemografike të pacientëve (N=106)	47
Tabela 3. 2 Sjellja e pacientëve dhe karakteristikat klinike.....	53
Tabela 3. 3 Prevalenca e depresionit dhe çrregullimeve neurokonjitive	57
Tabela 3. 4 Niveli i depresionit për totalin e pacientëve dhe sipas gjinisë	58
Tabela 3. 5 Shoqërimi i depresionit me çrregullimet neurokonjitive	60
Tabela 3. 6 Prevalenca e depresionit sipas karakteristikave sociodemografike	61
Tabela 3. 7 Prevalenca e depresionit sipas karakteristikave klinike dhe të sjelljes	64
Tabela 3. 8 Faktorët e riskut për depresion. Analiza multivariate	67

Lista e figurave

Figura 3. 1 Shpërndarja e rasteve sipas gjinisë	48
Figura 3. 2 Histogrami i moshës së pacientëve.....	48
Figura 3. 3 Krahasimi i moshës sipas gjinisë.....	49
Figura 3. 4 Shpërndarja e rasteve sipas grupmoshës	49
Figura 3. 5 Shpërndarja e rasteve sipas gjëndjes civile nivelit arsimor dhe vendbanimit	50
Figura 3. 6 Shpërndarja e rasteve sipas numrit të fëmijëve	51
Figura 3. 7 Shpërndarja e rasteve sipas statusit të shtëpisë.....	51
Figura 3. 8 Shpërndarja e rasteve sipas punësimit.....	52
Figura 3. 9 Shpërndarja e rasteve sipas numrit të fëmijëve me HIV	52
Figura 3. 10 Frekuenca e përdorimit të alkoolit dhe drogës	54
Figura 3. 11 Gjendja shëndetësore e pacientëve.....	54
Figura 3. 12 Stadi klinik sipas pranisë së simptomave	55
Figura 3. 13 Stadi i sëmundjes.....	55
Figura 3. 14 Frekuenca e infeksioneve oportunistike të kaluara	56
Figura 3. 15 Niveli i CD4 në matjen e fundit	56
Figura 3. 16 Aderenca ndaj TAR.....	57
Figura 3. 17 Prevalenca e depresionit dhe çrregullimeve neurokonjitive.....	58
Figura 3. 18 Niveli i depresionit për totalin e pacientëve	59
Figura 3. 19 Niveli i depresionit sipas gjinisë.....	59
Figura 3. 20 Shoqërimi i depresionit me çrregullimet neurokonjitive.....	60
Figura 3. 21 Shoqërimi i depresionit me karakteristikat sociodemografike	62
Figura 3. 22 Shoqërimi i depresionit me karakteristikat sociodemografike	63
Figura 3. 23 Shoqërimi i depresionit me karakteristikat klinike.....	65
Figura 3. 24 Shoqërimi i depresionit me karakteristikat klinike.....	66

Abstrakt

Hyrje: Çrregullimet konjitive që ndodhin në terren të infeksionit nga virusi i imunodeficiencës humane (HIV) janë njohur prej kohësh si një aspekt i rëndësishëm dhe invalidizues i sëmundjes.

Qellimi: Vlerësimi e prevalencës së depresionit dhe çrregullimeve konjitive tek personat me infeksionin HIV/AIDS.

Materiali dhe metoda: Ky është një studim cross-sectional i kryer pranë Klinikës Ambulatore për HIV/AIDS, Shërbimit Infektiv dhe Shërbimit të Dermatologjisë të QSUT gjatë periudhës kohore 2010-2015. Në studim janë përfshirë të gjithë rastet e pacientëve adulte mbi 18 vjeç të diagnostikuar me infeksion HIV/AIDS të rregjistruar dhe ndjekur pranë klinikës ambulatore dhe Shërbimit Infektiv të QSUT.

Në studim janë përdorur dy pyetësore: -Beck Depression Inventory II (BDI-II) - International HIV Dementia Scale (IHDS).

Rezultate: Në studim morën pjesë 106 pacientë nga të cilët 33% femra dhe 67% meshkuj. Moshë mesatare e pacientëve është 40.6 (± 9.6) vjeç që varion nga 25-59 vjeç. Prevalenca e depresionit në studim rezultoi 27.4% (95%CI 19.18 - 36.91)

Prevalenca e çrregullimeve neurokonjitive 20.8% (95%CI 13.52 - 29.76) dhe prevalenca e depresionit bashkë me çrregullime neurokonjitive 11.3% (95%CI 5.97 - 18.91). Në studim u gjet shoqërim sinjifikant i depresionit dhe çrregullimeve neurokonjitive ($p < 0.01$). U gjet shoqërim sinjifikant i depresionit sipas gjinisë ($p = 0.04$), grupmoshës ($p = 0.03$), numrit të fëmijëve ($p < 0.01$), statusit të shtëpisë ($p = 0.04$) dhe fëmijëve me HIV ($p = 0.03$), me përdorimin e alkoolit ($p < 0.01$), përdorimin e drogës ($p < 0.01$), gjendjen e keqe shëndetësore ($p = 0.02$) infeksione oportunistike të kaluara ($p < 0.01$), nivelin e fundit të CD4 ($p < 0.01$), ngarkesën virale ($p < 0.01$), dhe aderencën ndaj TAR ($p < 0.01$).

Përfundim: Faktorë të pavarur të riskut për depression rezultuan: grupmosha 41-50 vjeç; fëmijë me HIV; përdorim alkooli / droge; ngarkesa virale > 1000 , dhe aderenca jo e mirë ndaj TAR. Ekzaminimi për depresion duhet të kryhet rregullisht për të ofruar vlerësim të plotë dhe trajtim përkatës psikiatrik. Respektim rigoroz i terapisë antiretrovirale. Mbështetje psikosociale për personat e diagnostikuar me depresion.

Fjalë kyç: depresion, simptoma, prevalencë, HIV

I HYRJE

1.1 Çrregullimet Neurokonjitive të lidhura me HIV (HAND)

Çrregullimet konjitive që ndodhin në terren të infeksionit nga virusi i imunodeficiencës humane (HIV) janë njohur prej kohësh si një aspekt i rëndësishëm dhe invalidizues i sëmundjes. Ato njihen me një sërë termash. Terminologjia aktuale, çrregullimi neurokonjitiv i lidhur me HIV (HAND) dhe nënklasifikimet e tij, u artikulluan në 2004 në konferencën Frascati (1). Përveç efekteve të tij në imunitetin qelizor, HIV hyn në sistemin nervor qendror (SNQ) në fillim të dekursit të infeksionit dhe shkakton disa gjendje të rëndësishme të SNQ gjatë ecurisë së sëmundjes, të tilla si encefalopatia e HIV dhe HAND (2). Si pjesë e sindromës akute HIV gjatë serokonversionit, pacientët mund të përjetojnë encefalopatinë nga HIV. Encefalopatia progresive e lidhur me HIV (HPE) është një sindromë komplekse me karakteristika të sjelljes, konjitive dhe motorike që vërehet tek fëmijët (3). Përpara futjes në përdorim të terapisë antiretrovirale shumë aktive (HAART), demenca ishte një nga shkaqet më të zakonshme të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në pacientët me HIV. Ajo shihej më shpesh në stadin e fundit të AIDS, kur numri i limfociteve T CD4+ binte nën 200 qel/mL, dhe në rreth 50% të pacientëve para se të ndërronin jetë. Në v.1986, termi demencë e lidhur me HIV-in (HAD) u fut në përdorim për të përshkruar një kompleks unik gjetjesh neurobiheviore (4). Kur hyri epoka e trajtimit të HIV me HAART, çrregullimet neurokonjitive mbetën sërish të përhapura, ku studimet e tërthorta sugjeronin një shkallë dëmtimi konjitiv në rreth 44% të pacientëve (5). Natyra dhe severiteti i dëmtimit ndryshuan me futjen dhe përhapjen e terapisë HAART, megjithatë, me konsensus në v.2004 u përcaktua një përkufizim i ri për çrregullimet neurokonjitive të lidhura me HIV (6). HAND përfshin hierarkinë progresive të modeleve neurologjike deri në ato më severet. Ajo përkufizohet si një dëmtim i fituar i funksioneve konjitive ku të paktën 2 aftësi janë të dëmuara, duke çuar në përkeqësim në funksionimin ditor në rastet e rënda. Spektri varion nga dëmtimet neurokonjitive asimptomatike (ANI) në çrregullime minore neurokonjitive (MND) drejt demencës severe të lidhur me HIV (HAD) (7). Në epokën para HAART, HAD zhvillohej më shumë në pacientët me ngarkesë virale të lartë dhe CD4 < 200, ndërsa HAND zhvillohej në pacientët me CD4 normale (8). Barra psikosociale dhe emocionale e familjes dhe miqve të pacientit me HAND është e jashtëzakonshme. Pacientët me vështirësi konjitive kanë probleme me aderencën ndaj regjimeve terapeutike, ndjekjen e vizitave ambulatorë, dhe me qasjen ndaj shëndetit në përgjithësi. Për shkak të problemeve neuropsikiatrike, këta pacientë mund të shfaqin sjellje të rrezikshme (psh, marrëdhënie seksuale të pambrojtura), dhe mund të kenë risk më të lartë për transmetimin e virusit. Përveç vetë virusit HIV, shkaqe të tjera të komplikacioneve neurologjike të individëve të infektuar me HIV përfshijnë infeksionet oportuniste, tumoret, sëmundjet autoimune dhe barnat antiretrovirale. Përveç kësaj, pacientët janë në rrezik për shumë komplikacione të tjera

neurologjike të infeksionit HIV, përfshirë mielopatinë vakuolare, neuropatinë periferike dhe polimiozitin, të cilat mund të kontribuojnë në paaftësi të mëtejshme.

Çrregullimi i depresionit madhor është problemi psikiatrik më i shpeshtë i vërejtur në pacientët e infektuar me HIV. Një përqindje e individëve kanë distimi, me ose pa depresion madhor. Shumica e këtyre pacientëve kanë histori depresioni edhe para infektimit me HIV. Të dhënat nuk tregojnë një lidhje midis shkallës së çrregullimeve depressive dhe fazës së sëmundjes HIV ose shkallës së imunosupresionit. Meqenëse trajtimet antidepressive tolerohen mirë dhe mund të jenë jashtëzakonisht efektive në të gjitha fazat e sëmundjes HIV, identifikimi i çrregullimeve klinike depressive është shumë i rëndësishëm (9).

Termi "depresion" përdoret për të përshkruar kushte të ndryshme, duke përfshirë gjendjet blu kalimtare, trishtimin e butë por të vazhdueshëm dhe sëmundjen klinike. Depresioni klinik përkufizohet si një grup simptomash specifike që shfaqen sëbashku çdo ditë ose pothuajse çdo ditë për një periudhë të caktuar kohore. Forma kryesore e çrregullimit depresiv është depresioni madhor, i cili shpesh është i kufizuar në kohë, por i përsëritur, dhe distimia, e cila është një gjendje kronike.

1.2 Përcaktimi i depresionit

Diagnoza e depresionit madhor, sipas nozologjisë aktuale psikiatrike (DSM-IV), (10) kërkon praninë e të paktën 5 nga 9 simptomave specifike gjatë një periudhe 2-javore, por duhet të përfshijë gjithashtu humorin depresiv shumicën e ditës, pothuajse çdo ditë, ose një ulje të dukshme të interesit dhe kënaqësisë pothuajse në të gjitha aktivitetet. Simptoma të tilla jo vetëm që duhet të jenë të pranishme, por ato gjithashtu duhet të "shkaktojnë shqetësim ose dëmtim të rëndësishëm klinik në fusha sociale, profesionale ose fusha të tjera të rëndësishme të funksionimit" për të definuar diagnozën (10). Zakonisht, diagnoza e depresionit madhor nuk mund të arrihet derisa të përjashtohet ndonjë efekt fiziologjik i drejtpërdrejtë i një substance (duke përfshirë abuzimin me substanca ose medikamentet e përshkruara) ose gjendjen e përgjithshme mjekësore (11). Diagnoza e depresionit madhor mund të arrihet vetëm nëse simptomat depressive vazhdojnë për më shumë se 2 muaj ose karakterizohen nga "dëmtime të theksuara funksionale, shqetësime për paaftësinë, ide vetëvrasëse, simptoma psikotike ose vonesë psikomotore" (12). Distimia është një çrregullim kronik, shpesh me çrregullime të lehta të humorit, me një kohëzgjatje minimale prej 2 vjetësh, gjatë së cilës personi ndihet në depresion në shumicën e ditëve; Ky çrregullim nuk mund të thuhet se ekziston nëse personi ka përjetuar një periudhë mirëqenieje që zgjat të paktën 2 muaj gjatë një periudhe 2 vjeçare (13). Humori depresiv i lidhur me distiminë, shoqërohet me simptoma të tjera depressive që nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kriteret për depresion madhor. Disa pacientë kanë depresion madhor (aktualisht, 5 ose më shumë nga 9 kriteret e

kërkuara) dhe depresion kronik (për 2 ose më shumë vite); këto gjendje depresive shoqëruese nganjëherë referohen si "depresion i dyfishtë".

Identifikimi i depresionit në kontekstin e çrregullimeve mjekësore mund të ndërlikohet nga simptomat somatike të përbashkëta për të dy çrregullimet (14). Për shembull, lodhja, letargjia, libido e ulët, oreksi i ulët dhe humbja e peshës mund të jenë gjithashtu manifestime të sëmundjes HIV ose çrregullimeve depresive. Në të kundërt, simptomat konjitive dhe afektive si trishtimi, humbja e interesit për aktivitetet e dikurshme të pëlqyeshme, ndjenja e fajit, nervozizmi ose idetë vetëvrasëse pasqyrojnë vetëm gjendjen e humorit. Kur përdoren shkallë të standardizuara të vlerësimit të depresionit ose kritere diagnostikuese, vëmendja duhet të përqendrohet në simptomat afektive ose konjitive të depresionit. Diagnoza e çrregullimeve depresive mund të vendoset në mënyrë të besueshme nga mjekë që kanë eksperiencë si me depresionin ashtu edhe me manifestimet e sëmundjes HIV dhe medikamentet e saj.

1.3 Epidemiologjia

Raportet e hershme përshkruese të sëmundshmërisë psikiatrike në individët me infektion HIV mbështeteshin kryesisht në shkallët e vlerësimit të vetë-raportimit dhe mostrat e parë në mjediset mjekësore dhe përshkruanin shkallë jashtëzakonisht të larta të depresionit simptomatik dhe ankthit (15). Studimet e mëvonshme të mostrave të mbledhura në komunitet dhe nga vullnetarët, duke përdorur instrumente diagnostikuese të strukturuar dhe intervistues profesionistë të trajnuar (16) ose pyetësorë të simptomave, (17) kanë gjetur një shkallë të çrregullimeve depresive aktuale në meshkujt homoseksualë HIV-seropozitivë përafërsisht të barabarta me normat që shihen për meshkujt homoseksualë seronegativë. Rezultatet janë të përziera kur normat aktuale për popullatat seropozitive me HIV krahasohen me normat totale të popullsisë. Në përgjithësi, shkallët e depresionit shfaqen disi më të larta në grupet e infektuara me HIV, por janë të rritura në mënyrë të ngjashme për grupet e krahasimit HIV-seropozitivë dhe HIV-seronegativë që janë studiuar. Nëse normat e vëzhguara konsiderohen të larta apo të ulëta, është çështje interpretimi dhe mendimet e ekspertëve ndryshojnë.

Edhe pse normat e depresionit madhor janë zakonisht në fokus, distimia mund të jetë pothuajse po aq e zakonshme sa depresioni madhor tek personat e infektuar me HIV. Në 3 nga 4 studimet që përdorën vlerësime të strukturuar diagnostikuese për subjektet kryesisht asimptomatike HIV-seropozitive, u zbulua se normat e prevalencës për distiminë ishin dy herë më të larta te meshkujt HIV-seropozitivë sesa në grupet e krahasimit me HIV-seronegativë (18). Në një studim ndër-seksional me 112 meshkuj me AIDS, 3% kishin depresion madhor, 10% kishin distimi dhe një shtesë prej 4% kishin depresion madhor plus distimi (19).

Është e rëndësishme të pranohet se shumica e njerëzve të infektuar me HIV, të cilët megjithëse nuk kanë një çrregullim klinik depresiv, ka të ngjarë të përjetojnë periudha trishtimi dhe shqetësimi herë pas here, veçanërisht në lidhje me sëmundjet ose vdekjen e miqve. Për shembull, në një studim me 53 të mbijetuar nga AIDS për një kohë të gjatë, (20) pjesëmarrësit u pyetën: "Si ka qenë humori juaj kohët e fundit? A jeni ndjerë mjaft i gëzuar apo i dëshpëruar?" Nga të anketuarit, 42% u përgjigjën se ndiheshin të gëzuar, dhe 42% të tjerë përshkruan ndjenjat kalimtare të trishtimit. 11% të tjerë kishin disa simptoma depresive, megjithëse vetëm 6% kishin në të vërtetë çrregullime depresive aktuale. Këto gjendje të përkohshme të humorit nuk regjistrohen në mënyrë rutinë në studimet epidemiologjike, dhe për këtë arsye nuk ekzistojnë grupe krahasimi. Megjithatë, mungesa e një episodi depresiv aktual nuk nënkupton domosdoshmërisht një mungesë totale të shqetësimit.

Në studimet e përshkruara më parë, raportet ishin ndërseksionale dhe pjesëmarrësit në studim, megjithëse HIV seropozitivë, ishin në pjesën më të madhe të shëndetshëm, me mungesë të simptomave deri në simptoma të moderuara të HIV. Megjithëse normat e depresionit madhor të gjetur në këto studime ishin relativisht të ulëta, studimet nuk ngritën pyetjen se normat e depresionit rriten ndërsa sëmundja HIV përparon dhe njerëzit sëmuren më shumë.

Studimet vijuese të meshkujve dhe femrave të infektuara me HIV sugjerojnë se shkalla e depresionit nuk rritet me kalimin e kohës. Megjithatë, në pjesën më të madhe, pjesëmarrësit e studimit ishin ose asimptomatikë ose lehtësisht simptomatikë gjatë gjithë periudhës së vëzhgimit. Joseph dhe kolegët (21) përdorën shkallët e vetëvlerësimit për të vlerësuar simptomat e depresionit te pacientët në 6 vizita gjashtëmujore të grupit të Çikagos të Studimit Multicentrik të AIDS Cohort (MACS), nga viti 1984 deri në 1988. Ata gjetën rezultate të qëndrueshme me kalimin e kohës pa asnjë rritje në psikopatologji. Perry dhe kolegët (22) kryen ndjekje 6-mujore dhe 1-vjeçare të 328 meshkujve homoseksuale dhe heteroseksuale HIV-seronegative dhe seropozitive dhe femrave, të cilët fillimisht erdhën për testimin e antitropave HIV. Numri mesatar i qelizave T CD4+ për subjektet seropozitive me HIV ndryshoi nga 449 qeliza/mm³ në fillim në 418 qeliza/mm³ pas 1 viti, kohë në të cilën 11 subjekte plotësuan kriteret për AIDS (përkufizimi i CDC 1987). Studiuesit gjetën një rënie në severitetin e simptomave depresive me kalimin e kohës si në shkallët e vlerësuara nga klinikistët, ashtu edhe ato vetë vlerësuarat, pa dallim midis subjekteve HIV-seropozitive dhe seronegative në asnjë rast. Studimet me ndjekje më të gjatë kanë gjetje të ngjashme. Rabkin dhe kolegët kryen vlerësime diagnostikuese dhe vlerësime të simptomave të depresionit në një grup prej 120 përdoruesish të drogave me injeksion, meshkuj dhe femra HIV-seropozitive, të parë në 7 vizita gjashtëmujore (23). Normat e çrregullimeve depresive ishin të larta për të gjitha grupet, pavarësisht nga statusi i serokonvertimit fillestar, por nuk u rritën gjatë ndjekjes 3-vjeçare. Një studim 4-vjeçar i meshkujve homoseksualë i kryer nga të njëjtët studiues

(24) zbuloi se nivelet e stresit ishin të ulta, por dukshëm më të larta për meshkujt HIV-seropozitiv krahasuar me meshkujt HIV-seronegativë në fillim, pa asnjë ndryshim në normat e çrregullimit depresiv klinik. Ky ndryshim mbeti konstant me kalimin e kohës, pa rritje të shkallës së çrregullimeve depressive apo stresit midis meshkujve të infektuar me HIV, pavarësisht progresit të sëmundjes. Të dhënat kumulative nuk e mbështesin nocionin e rritjes së shkallës së çrregullimit depresiv me përparimin e sëmundjes HIV.

2.0 Depresioni, statusi imunitar dhe përparimi i sëmundjes

A mund të gjendet një lidhje mes çrregullimeve depressive ose simptomave dhe markuesve të imunosupresionit? Dhe, a përparon më shpejt sëmundja e HIV - it te individët e infektuar me HIV që janë në depresion, sesa te ata që nuk janë në depresion?

Në një studim longitudinal të 112 meshkujve homoseksualë HIV-seropozitivë të vlerësuar në intervale 6-mujore, nuk gjetëm lidhje midis depresionit sindromik, detresit psikiatrik, ose stresorëve psikosocialë të tilla si ngjarjet e jetës dhe statusit imunitar ose faza e sëmundjes së HIV, qoftë në mënyrë të kryqëzuar ose mbi 6 muaj (25). Ata që ishin depresë ose të shqetësuar, ose që raportuan më shumë stresorë të jetës, nuk kishin imunosupresion më të madh ose fazë më të avancuar të sëmundjes se të tjerët, qoftë në të njëjtën kohë ose me kalimin e kohës. Gjetje të ngjashme janë raportuar nga Perry dhe kolegët (26) në një mostër heterogjene të 221 meshkujve dhe femrave HIV-seropozitivë, nga Evans dhe bashkëpunëtorët që studiuuan 99 meshkuj asimptomatikë HIV-pozitivë dhe 65 HIV-negativë në grupin e studiuar prej tyre në Karolinë, (27) dhe nga Kessler dhe kolegët, (28) që nuk gjetën asnjë lidhje midis ngjarjeve të jetës dhe përqindjes së qelizave T -CD4+ ose simptomave depressive në një mostër prej 300 meshkujsh homoseksualë HIV-seropozitivë. Kohët e fundit, Rabkin dhe të tjerë (29) nuk gjetën asnjë lidhje midis depresionit dhe ngarkesës virale të HIV RNA në një studim të kontrolluar ndër-seksional të meshkujve me AIDS.

Studimet e publikuara për marrëdhëniet midis çrregullimeve depressive ose simptomave depressive dhe statusit imunitar dhe përparimit të sëmundjes në kontekstin e sëmundjes së HIV-it vazhdojnë të ofrojnë rezultate jo të qëndrueshme. Dy studime (30,31) të botuara në vitin 1993 ndoqën komunitetin e zgjedhur të meshkujve homoseksualë çdo 6 muaj gjatë 7 vjetëve. Të dy studimet përdorën të njëjtin ekzaminim vetë-raportues për problemet e humorit (Community Epidemiologic Survey-Depression [CES-D]). Asnjë studim nuk gjeti një lidhje të rëndësishme midis rezultateve CES-D në fillim të studimit dhe gjatë kohës së diagnostikimit të AIDS ose vdekjes, edhe pse ata diferencuashin në lidhje me efektin e simptomave depressive në shkallën e uljes së qelizave T-CD4+.

Në vitin 1996, (32) u botua një raport tjetër, bazuar në të njëjtin grup që kishin studiuar në vitin 1993, në të cilin nuk gjetën asnjë lidhje midis vdekshmërisë dhe simptomave

depressive të nxjerra në bazë të studimit. Studimi i vitit 1996 zbuloi një rritje të simptomave depressive duke filluar që 18 muaj para se të diagnostikohet AIDS klinik. Depresioni i mëparshëm, simptomat e lidhura me HIV dhe stresuesit psikologjikë u zbuluan se kontribuonin në këtë rritje. Ky ekip spekuloi se faktorët biologjikë, të tillë si çrregullimi i sistemit imun, mund të ndikonin gjithashtu.

Një studim i bërë nga Maynes dhe bashkëpunëtorët (33) siguroi dëshminë e parë se simptomat depressive mund të lidhen me mortalitetin nga AIDS. Në Studimin e Shëndetit të Meshkujve të San Franciskos, CES-D u shpërnda në një grup në komunitet çdo 6 muaj. Përveç kësaj, disa matës të fazës së HIV-it u përdorën për të lidhur shkallën e sëmundjes me simptomat depressive. Subjektet përfshinin 402 meshkuj të vlerësuar në të paktën 3 dhe deri në 15 raste. Një matës kohor i simptomave depressive u llogarit si proporcioni i vizitave në të cilat rezultati i subjektit në elementët ndikues në CES-D tejkaloi një kufi të paracaktuar të severitetit. Një model i rreziqeve proporcionale Cox tregoi sesa më shpesh një subjekt të kishte nivele më të larta simptomash depressive, aq më i madh është risku i tij për vdekje, pavarësisht nga matjet biologjike dhe klinike të progresit të sëmundjes së HIV-it. Studiuesit nxorën përfundimin se «nëse depresioni po ndikon në mortalitet, nuk është nëpërmjet kanaleve të drejtpërdrejta fiziologjike ose të paktën jo ato që janë matur në këtë studim». Përfundime rreth vlefshmërisë së këtyre observimeve nuk mund të arrihen pa studime të mëtejshme. Një ekzaminim i tillë kritik duhet të përfshijë analiza më përfshirëse, shumica e të cilave nuk janë të mundshme në shkallë të gjerë, për shkak të kushteve dhe rrethanave biologjike, psikiatrike dhe psikosociale të pjesëmarrësve në studim.

2.1 Faktorët e riskut për Depresion në sëmundjen e HIV-it

Studimet e psikopatologjisë aktuale dhe të shkuar në mostrat e komunitetit të meshkujve homoseksualë kanë zbuluar norma çuditërisht të larta të çrregullimeve depressive gjatë jetës, pavarësisht nga normat e ulëta të depresionit aktual. Studiuesit nga 2 qendra të ndryshme në Nju Jork (34,35) raportuan mbizotërim të depresionit gjatë gjithë jetës në rangun prej 30% deri në 35%, krahasuar me normën e përgjithshme të popullsisë mashkullore prej rreth 13% (36). Duke pasur parasysh natyrën e përsëritur të çrregullimit, gjetjet sugjerojnë një vulnerabilitet më të madh ndaj episodeve të ardhshme të depresionit në këto grupe.

Në dijeninë tonë, asnjë studiues nuk i ka parë sistematikisht efektet në humor të barnave për HIV-in ose ndërveprimin e këtyre barnave me ato kundër depresionit. Disa raporte të botuara sugjerojnë se zidovudina mund të ketë ndikim në rritjen e humorit (37) ose të jetë nxitëse e manisë, (38) edhe pse ka gjithashtu raportime të rastësishme nga pacientët se zidovudina është depresogjenike. Për pacientin, simbolika psikologjike e fillimit të trajtimit antiretroviral mund të jetë e vështirë për t'u ndarë nga efektet kimike të përbërjes ose nga efektet e medikamenteve të shumta profilaktike ose akute të HIV të përshkuara

në recetë ndërkohë që sëmundja përparon. Në përgjithësi, duke pasur parasysh përdorimin e gjerë të medikamenteve për HIV, veçanërisht zidovudine, dhe mungesën e raporteve për efektet e rëndësishme në humor nga klinikistët ose pacientët, raportet e cituara mbi rastet mund të përfaqësojnë efekte idiosinkrazike dhe jo të zakonshme në humor.

Është sugjeruar, por nuk është demonstruar, se vetë HIV-i shkakton ndryshime humori dhe se demenca e lidhur me AIDS-in shkakton depresion. Markowitz dhe kolegët (39) kanë gjetur shumë pak prova për të mbështetur secilën nga këto hipoteza. Sterni dhe kolegët (40) nuk e gjetën gjendjen depresive të lidhur me ndryshimet e hershme konjitive në meshkujt HIV-seropozitive. Apatia, ndryshe nga trishtimi, duket se është mbizotëruese në demencën e lidhur me AIDS-in.

2.1.1 Faktorët e rrezikut lidhur sipas epokës HAART

Në epokën para HAART, faktorët e rrezikut të identifikuar për HAD ishin pesha e ulët, anemia, simptomat konstitucionale, numri i ulët i CD4+ dhe ngarkesa e lartë plazmatike e HIV-ARN. Në epokën post-HAART, faktori më i rëndësishëm i rrezikut për HAND është numri më i ulët i CD4, por faktorët e rrezikut përfshijnë gjithashtu moshën, hipertensionin dhe hiperlipideminë. Ky identifikim, së bashku me të dhënat neuroimazherike të HAND dhe dëmtimit konjitiv vaskular, ka bërë që të supozohet se plakja e parakohshme në njësinë neurovaskulare mund të jetë objektivi kryesor i dëmtimit të trurit të lidhur me HIV në popullatën e trajtuar me HIV (41). Studimi i grupit Multicenter të AIDS-it raportoi se moshë më e madhe shoqërohej me përparim më të shpejtë drejt demencës dhe vdekjes (X). Prevalenca e çrregullimeve konjitive tek personat që janë HIV pozitiv dhe më të vjetër se 50 vjeç është më e madhe se tek pacientët më të rinj (42).

Prezantimi i HAART pati dy ndikime të mëdha në epidemiologjinë e çrregullimit neurokonjitiv të lidhur me HIV (HAND). Së pari, prevalenca e formës më të rëndë, demencës së lidhur me HIV, e cila ishte vlerësuar në 10-15%, u bë e rrallë, e matur në vetëm 2% në studimin CHARTER. Së dyti, prevalenca e përgjithshme e HAND, e përfaqësuar nga format e saj më të lehta, u rrit ndjeshëm në 44%. Çuditërisht, studimi zbuloi se shkalla e dëmtimit konjitiv ishte më e lartë në popullatën e trajtuar me HAART sesa në grupin jashtë trajtimit, gjë që mund të pasqyrojë ashpërsinë e sëmundjes dhe kohëzgjatjen e infeksionit (43). Një meta-analizë që përpiket të përcaktojë prevalencën globale të HAND vlerësoi se ishte 42.6% në 88% të rasteve që përfaqësonin formë të lehtë të sëmundjes. Përqindja e pacientëve me HAND u ul me nivelin e të ardhurave, numrin e CD4 dhe trajtimin me HAART. Gjetjet sugjerojnë se fillimi i hershëm i HAART dhe parandalimi i imunosupresionit të rëndë (dhe, në këtë mënyrë, CD4 nadir) reduktoi si prevalencën ashtu edhe severitetin e HAND. Prevalenca në Afrikën Sub-

Sahariane dhe Amerikën Latine mund të jetë më e lartë se në Shtetet e Bashkuara dhe Evropën Perëndimore (44).

2.2 Fizpatologjia

Virusi i HIV mendohet se hyn në tru nëpërmjet limfociteve dhe makrofagëve të infektuar. Mekanizma të tjerë të propozuar janë pasazhimi i virusit të lirë drejt trurit dhe çlirimi i tij nga qelizat endoteliale të infektuara (45). Virusi replikohet në këto qeliza dhe mund të infektojë qelizat e tjera, si mikroglia, oligodendrocitet, astrocitet, dhe neuronet; makrofagët dhe mikroglia janë qelizat që infektohen më shpesh. Infeksioni HIV në SNQ mund të zbulohet dhe monitorohet duke matur ngarkesën virale në lëngun cerebrospinal (LCS). Është vendosur një korrelacion pozitiv midis ngarkesës virale të LCS dhe shkallës së disfunksionit konjitiv. Studimet imunohistokimike tregojnë se virusi ndodhet më dendur në ganglionet bazale, regjionin subkortikal dhe korteksin frontal. Ndryshimet patologjike në autopsi janë gjithashtu kryesisht subkortikale, duke përfshirë lëndën gri të thellë (p.sh., ganglionet bazale, talamus) dhe regjionet e lëndës së bardhë. Mekanizmi me të cilin infeksioni HIV i SNQ-së çon në çrregullime neurokonjitive mund të jetë shumëfaktorial dhe është objekt i një studimi intensiv.

2.2.1 Proteinat qelizore

Dëmtimi i përhapur patologjik mund të ndodhë nëpërmjet përgjigjeve indirekte qelizore me sekretimin e kemokinave, citokinave proinflamatore, oksidit të azotit dhe faktorëve të tjerë neurotoksikë. Këto produkte prodhohen jo vetëm nga qelizat e infektuara (p.sh. makrofagët, astrocitet, mikroglia) por edhe nga qelizat e aktivizuara jo të infektuara. Shumë vëmendje i është kushtuar kemokinave, si CCL4 dhe CXCL12, dhe receptorëve të tyre respektivë të kemokinës, CCR5 dhe CXCR4. Këto mund të ndikojnë në shumë procese qelizore, duke përfshirë migrimin neuronal, apoptozën dhe rregullimin e neurotransmetuesve.

2.2.2 Proteinat e HIV (virotoksina)

Studimet në disa modele transgjenike në minj tregojnë se shprehja e një gjeni të vetëm ose të shumëfishtë të HIV çon në anomali klinike dhe histologjike (46). Dëmtimi i neuroneve mund të ndodhë nëpërmjet veprimeve të proteinave specifike të HIV-it, duke përfshirë gp120, gp41, Tat, Nef, Vpr dhe Rev. Këto proteina virale mund të jenë drejtpërdrejt toksike për qelizat neuronale ose mund të shkaktojnë dëmtime duke aktivizuar astrocitet, mikroglinë dhe makrofagët për të çliruar citokina, kemokina ose substanca neurotoksike (47). Duke nxitur unazat e reagimit, virotoksinat mund të përforcojnë toksicitetin e tyre dhe të shkaktojnë dëmtime gjithandej.

2.2.3 Sëmundjet autoimune

Dëmtimi i SNQ mund të ndodhë nga mekanizmat imunitar humoralë, siç dëshmohet nga prania e antittrupave anti-SNQ në pacientët me AIDS me demencë, por jo në ata pa demencë (47). Autoantittrupat kundër glikoproteinës së oligodendrocitit të mielinës mund të persistojnë në një përqindje të lartë të pacientëve pavarësisht klirensit viral; Ky zbulim sugjeron neuroinflamacion të vazhdueshëm, i cili nuk lejon shërimin nga çrregullimi neurokognitiv i lidhur me HIV (48).

3.0 Paraqitja Klinike

Aktualisht, vlerësohet se gati gjysma e të gjithë pacientëve me HIV kanë performancë më të ulët sesa pritej në vlerësimet e ndryshme neuropsikologjike krahasuar me individë të shëndetshëm me të njëjtën moshë, racë, arsim dhe përkatësi etnike. Simptomat neuropsikiatrike si apatia, depresioni, ankthi dhe psikoza zakonisht shihen te këta individë. Tek këta individë vërehet edhe dëmtim i rëndësishëm i kujtesës. Ndryshimet e personalitetit, duke përfshirë tërheqjen sociale dhe, në disa raste ekstreme, gjendjen vegetative dhe mutizmin, mund të shihen gjithashtu. Jo të gjithë pacientët me çrregullim neurokognitiv të lidhur me HIV (HAND) përparojnë në demencë të lidhur me HIV (HAD). Fillimi i HAD është i lidhur me ngarkesën e lartë virale, CD4 nadir dhe kohëzgjatjen e vetë infeksionit. Me përdorimin e HAART, janë bërë të shpeshta format më të lehta të disfunksionit konjitiv, dëmtimi asimptomatik neurokognitiv (ANI) dhe çrregullimi minor neurokognitiv (MND). Vlerësimi konjitiv në pacientët me HAD demonstroi deficiete të kujtesës, abstraksionit, rrjedhshmërisë verbale, vendimmarrjes dhe vëmendjes. Karakteristika më të rralla përfshijnë problemet me gjumin, psikozën (me mani) dhe konvulsionet. Problemet motorike përfshijnë çrregullimet e ekuilibrit, ngathtësinë dhe dobësinë. Shenjat dhe simptomat e hershme janë delikate dhe mund të neglizhohen. Rrjedhimisht, testet konjitive skrinuese duhet të jenë pjesë e kujdesit rutinë për pacientët e infektuar me HIV, veçanërisht ata me rrezik të lartë, siç janë moshat e mëdha, ngarkesa e lartë plazmatike e acidit ribonukleik të HIV-it (ARN), numri i ulët i qelizave CD4+, hepatiti C dhe statusi konjitiv i dobët që në fillim. Në ANI dhe MND, aktivitetet e jetës së përditshme janë vetëm pak të dëmtuara. Kjo është në kontrast me dëmtimin e konsiderueshëm në HAD. Në foshnjat me encefalopati progresive të lidhur me HIV (HPE), tiparet karakteristike përfshijnë rënien intelektuale dhe motorike. Tek fëmijët e vegjël, shkalla e përvetësimit të aftësive të reja zvogëlohet dhe aftësia dhe shkathhtësia motorike mund të dëmtohen. Mund të zhvillohen edhe vështirësi në të ushqyer. Tek fëmijët dhe adoleshentët më të rritur, paraqitja është e ngjashme me atë të kompleksit të demencës së AIDS (ADC) tek të rriturit (49).

3.1 Dinamika virale

Zhvillimi i teknikave të biologjise molekulare për të matur HIV-1-ARN në plazmë ka zbuluar praninë e niveleve të larta të virusit në të gjithë ecurinë e infeksionit (50). Këto nivele të larta të HIV-1 në plazëm janë rezultat i një ekuilibri dinamik midis prodhimit të HIV - 1 në indet limfoide dhe pastrimit të vazhdueshëm të virusit nga sistemi imunitar. Është vlerësuar se deri në 10 miliardë [10^{10}] grimca të HIV - 1 prodhohen dhe pastrohen çdo ditë në një individ të infektuar (51). Ky ekuilibër dinamik rezulton në qarkullim të vazhdueshëm të popullatës së virusit, dhe përafërsisht gjysma e virusit që qarkullon zëvendësohet me virione të prodhuara rishtas çdo ditë (52). Kështu, gjysmë-jeta e HIV -1 në plazmë duket të jetë vetëm 1 deri në 2 ditë; gjysmë - jeta e virioneve infektive është në rendin e minutave (53). Analiza e mëtejshme e këtyre të dhënave tregon se prodhimi masiv i HIV është i lidhur fort me shkatërrimin dhe zëvendësimin e gati 2 miliard limfociteve CD4 çdo ditë.

Këto rezultate kanë disa implikime të rëndësishme. Pjesa më e madhe e HIV është prodhuar në indet limfoide dhe çlirohet shpejt në gjak. Prandaj, duke pasur parasysh gjysmë - jetën e shkurtër të virusit HIV, shumica e virusit të zbuluar në gjak ka qenë prodhuar kohët e fundit. Qelizat që prodhojnë virusin janë gjithashtu me jetë të shkurtër, me një gjysmë jete të përafërt prej 1.2 ditë. Pasi limfocitet e infektuara produktive janë eliminuar, një fazë e ngadalshme, një fazë e dytë e shkatërrimit bëhet e evidente. Kjo fazë e dytë besohet të përfshijë humbjen më graduale të qelizave të infektuara me jetë më të gjatë, të tilla si makrofagët, dhe limfocitet e infektuara më vonë që mund të aktivizohen për të prodhuar virusin (54). Modelimi matematik sugjeron se shkatërrimi i qelizave të infektuara me jetë më të gjatë, që kanë një gjysmë -jetë mesatare prej 14 ditësh, është përcaktuesi kryesor i fazës së dytë të shkatërrimit.

Studimet e qarkullimit HIV në nyjet limfatike nga individët e infektuar kanë dhënë rezultate të ngjashme. Duke përdorur teknikat e hibridizimit in situ dhe analizën kompjuterike të imazhit, investiguesit kanë qenë në gjendje të bëjnë dallimin midis HIV-1 ARN të akumuluar brenda qelizave individuale (të cilat besohet se përfaqësojnë limfocite të infektuara produktive) dhe virionit shoqëruar të ARN-së të lidhur me sipërfaqen e qelizave dendritike brenda nyjeve limfoide (qelizat folikulare dendritike). Studimet e mëparshme kishin ngritur diskutime se HIV-1 i lidhur te qelizat folikulare dendritike mund të mbetet jainfektiv për periudha shumë të gjata dhe potencialisht përbën një rezervuar për një kohë të gjatë që mund të persistojë pavarësisht terapisë antiretrovirale efektive. Megjithatë, studimet e mëvonshme tregojnë se numri i qelizave mononukleare të infektuara produktive në një nyje limfatike ulet, me një gjysmë jetë rreth 1 ditë, pas fillimit të terapisë antiretrovirale të fuqishme. Përveç kësaj, sasia e virusit të bllokuar nga qelizat folikulare dendritike ulet gjithashtu me një gjysmë-jetë të ngjashme.

Kështu, 6 muaj të trajtimit rezultuan me pastrimin e më shumë se 99,9 % të HIV - 1 që lidhet me këtë rezervuar limfoid (55).

Ndërsa terapitë e fuqishme kanë lejuar të identifikojnë gjysmë jetën e kompartimenteve të ndryshme virus-prodhuese, pyetja në vijim është: Nëse replikimi i HIV-1 mund të frenohet plotësisht, sa kohë do të duhet të mbahet trajtimi deri sa HIV-1 të zhduket? Edhe pse vlerësimet fillestare sugjeruan se 2 deri në 3 vjet te frenimit të vazhdueshëm mund të rezultojë në eliminimin e rezervuarëve jetë – gjatë të qelizave të infektuara me HIV, të dhënat aktuale tregojnë se popullata e qelizave të infektuara fshehurazi shkatërrohet shumë ngadalë (56).

Studimet e fundit ofrojnë dëshmi të mëtjshme për ekzistencën e një rezervuari jetëgjatë të limfociteve të kujtesës CD4 në qetësi, të infektuara fshehurazi. Replikimi-kompetent i HIV-1 mund të mbulohet nga këto qeliza të infektuara fshehurazi, nga përdorimi i teknikave të ndjeshme të mbjelljes (57).

Shkalla e qarkullimit të këtyre qelizave është një çështje me disa polemika. Në një studim, gjysmë-jeta e qelizave të kujtesës CD4, të infektuara fshehurazi është vlerësuar të jetë rreth 43 muaj, ndërsa një studim i dytë dokumenton një gjysmë jetë prej vetëm 6 muaj (58). Një shpjegim i mundshëm për këtë mospërputhje të dukshme është ofruar nga një studim i kohëve të fundit në të cilin është gjetur shkalla e shkatërrimit të rezervuarit latent është në funksion të shtrirjes së frenimit të virusit. Nivelet e shkatërrimit ishin dukshëm më të shpejta në pacientët me shtypje të vazhdueshme të HIV-1 ARN në plazmë, në më pak se 50 kopje / ml gjatë terapisë antiretrovirale të fuqishme sesa në pacientët të cilët kishin episode të rastit të "përparimit" të viremisë (59).

Ndryshimi në plazmë i HIV-1 RNA pas trajtimit me zidovudinë, lamivudinë dhe ritonavir. Ndodh një reduktim fillestar i shpejtë i nivelit të ARN, dhe kjo reflekton eliminimin e prodhimit aktiv të qelizave të infektuara. Së dyti, faza e rënies së ngadaltë është rezultat i eliminimit me gradual të qelizave të infektuara me jetë më të gjatë.

Qelizat e aktivizuara që infektohen me HIV prodhojnë viruse dhe vdesin brenda 1 ose dy ditësh. Prodhimi i virusit nga qelizat e aktivizuara jetë-shkurtër përbën pjesën më të madhe të virusit prezent në plazmë. Koha e nevojshme për të përfunduar një cikël jete të plotë për virusin HIV është 1.5 ditë. Qelizat në qetësi që infektohen, prodhojnë virus vetëm pas stimulimit imun; këto qeliza kanë një gjysmë-jetë të paktën 5 deri 6 muaj. Disa qeliza janë infektuar me virusin e dëmtuar kështu që nuk mund të përfundojnë ciklin e jetës së virusit. Qelizat të tilla kanë një, jetojnë shumë gjatë, dhe kanë një gjysmë-jetë të vlerësuar rreth 3 deri në 6 muaj (60).

Niveli i pastrimit të plazmës nga HIV-1 duket të jetë i pavarur nga statusi imunologjik (siç gjykohet nga numri i qelizave CD4). Për shkak se niveli i pastrimit ndryshon pak nga një individ tek tjetri, niveli i prodhimit të virusit është faktori kryesor përcaktues për

nivelin e virusit në gjak. Shikuar nga një perspektivë tjetër, sasia e virusit të pranishëm në gjak është drejtpërdrejt e lidhur me normën e prodhimit të virusit. Sepse shkatërrimi i qelizave CD4 është i lidhur direkt me prodhimin e virusit, përcaktimi sasior i niveleve të HIV-1 ARN në plazmë, siguron një vlerësim të shkallës së shkatërrimit të qelizave CD4. Kjo marrëdhënie ndërmjet ngarkesës virale dhe shkatërrimit të qelizave CD4 shpjegon pse niveli plazmatik i HIV-1 ARN është një tregues i fuqishëm prognostik (61).

Infeksioni HIV-1 është një proces dinamik që përfshin prodhimin dhe pastrimin e sasive masive të virusit çdo ditë. Sasia e virusit në gjak është direkt e lidhur me nivelin e prodhimit të virusit, i cili përcakton nivelin e shkatërrimit të qelizave CD4.

3.2 Variacioni viral

Sipas Medscape, dinamika e replikimit të HIV ka gjithashtu implikime të thella për zhvillimin e diversitetit gjenetik të quasispecies HIV në individë (pacientë) (62). Izolimet e virusit, të marra nga pacientët në kohën fillestare të infeksionit, tregojnë heterogjenitet të vogël gjenetik. Me kalimin e kohës, popullata e viruseve që qarkullojnë në një pacient bëhet gjithnjë e më e larmishme. Kinetika e shpejtë e replikimit dhe shkalla e lartë e mutacionit të transkriptazës reverse të virusit HIV drejtojnë diversitetin e virusit HIV në varësi të presionit të përzgjedhur të përgjigjes imune të strehuesit (pacientit).

Qarkullimi i shpejtë i HIV-it siguron mekanizmin ideal për prodhimin e varianteve me mutacioneve që japin rezistencë ndaj medikamenteve apo lejojnë arratisjen nga kontrolli imunologjik i infeksionit HIV. Kur medikamentet që pengojnë replikimin e HIV-1 janë pjesërisht ose të administruar në mënyrë jo të përshtatshme, do të rezultojë në shfaqjen e shtameve rezistente. Në rastin e lamivudinës (3TC) ose nevirapinës, një ndryshim i vetëm nukleotidi në genin e transkriptazës reverse të HIV-1 është i mjaftueshëm për të shkaktuar rezistencë të nivelit të lartë. E gjithë popullsia e virusit zhvillohet drejt virusit rezistent, brenda pak javësh, kur këto medikamente janë dhënë si agjentë të vetëm (63). Pak variacion viral ose aspak shfaqet në pacientët me supresion të plotë të HIV-1 ARN në plazmë në përgjigje të kombinimit të terapisë së fuqishme (64).

4.0 Rënia e numrit të qelizave CD4 dhe përparimi i sëmundjes

Megjithëse psikostimulantët historikisht janë përdorur si antidepressantë përpara ardhjes së barnave moderne antidepressive në mesin e viteve 1960, ata pësuan një disfavor për shkak të potencialit për abuzim kur përdoren për përdorim rekreativ. Studiuesit (112) rishikuan 10 studime të kontrolluara me placebo të stimuluesve për trajtimin e depresionit dhe arritën në përfundimin se këto barna ishin efektive vetëm për pacientët ambulatorë me depresion të lehtë ose ata me simptoma si lodhje të theksuar ose apati. Holmes dhe kolegët (113) përdorën metilfenidatin me sukses për trajtimin e pacientëve të infektuar me HIV me probleme konjitive.

Rabkin (114) kreu një studim pilot të hapur të dekstroamfetaminës për pacientët me HIV, letargji të rëndë, humor të ulët dhe numër shumë të ulët të qelizave T CD4+. Një total prej 24 pacientësh filluan me dekstroamfetaminën, 5 mg/ditë në doza të ndara (mëngjes dhe mesditë), duke e rritur me 2,5 mg/ditë çdo 2 ditë pas kontaktit telefonik për të vlerësuar efektet anësore të mundshme dhe efektin klinik. Në fund të 1 jave, doza u rrit në 25 mg/ditë siç indikohet klinikisht. Projekti i studimit përfshinte një rritje të dozës në 30 mg/ditë pas 2 javësh; megjithatë, përmirësimi klinik u arrit në të gjithë pacientët me doza më të ulëta. Dozat maksimale varionin nga 5 mg/ditë deri në 20 mg/ditë.

Numri mesatar i qelizave T CD4+ në fillim në këtë popullatë në studim ishte 38/mm³ (rangu, 1 deri në 198/mm³). Nëntëmbëdhjetë nga 24 përfunduan të paktën 6 javë trajtim; 18 treguan përmirësime të mëdha si në humor ashtu edhe në energji. Dy pacientë e

ndërprenë trajtimin në javën e 6-të sepse u ndjenë në mënyrë të pakëndshme "të lidhur". Një tjetër ndaloi, pavarësisht përmirësimit të qartë të humorit, sepse nuk i pëlqente ideja e "energjisë kimike". Të tjerë kanë vazhduar të përdorin amfetamina deri në 2 vjet ose deri në vdekje.

Shqetësimet në lidhje me përdorimin e psikostimulantëve në pacientët me AIDS janë mundësitë e rritjes së ankthit dhe frenimit të oreksit. Në literaturën e disponueshme që përshkruan pacientët klinikisht të shëndetshëm me depresion, asnjë nga këto efekte anësore nuk është raportuar (115). Në përvojën tonë, pas disa ditësh trajtimi, pacientët shpesh zbulojnë se kanë energji të mjaftueshme për të blerë ushqim dhe për ta përgatitur atë, dhe kështu hanë më shumë. Efekti negativ kryesor që pacientët raportojnë është ndjenja "hiper", dhe kjo është trajtuar në mënyrë efektive duke reduktuar dozën. Ne kemi zbuluar se pacientët reagojnë ndaj dozave relativisht të ulëta dhe do ta rregullojnë dozën vetë çdo ditë sipas mënyrës se si ndihen atë ditë dhe çfarë duhet arrijnë. Shumica e këtyre pacientëve po merrnin njëkohësisht medikamente të HIV-it dhe analgjezikë, përfshirë tableta, morfinë të lëngshme ose intravenoze, pa asnjë ndërveprim problematik të barnave të raportuar ose vëzhguar (116).

Përdorimi i dekstroamfetaminës në këtë popullatë kërkon monitorim të kujdesshëm fillestar dhe titrim të dozës. Efektet pozitive të vërejtura deri më sot me psikostimulantët për përmirësimin e humorit të ulët dhe letargjisë së rëndë në kontekstin e sëmundjes HIV në stadin terminal janë inkurajuese.

9.0 Vlerësimi i përfitimeve të trajtimit

Sipas Medscape, përgjigjia dinamike e HIV-1 ARN në plazmë ndaj trajtimit, bën të mundur vlerësimin e efektivitetit të terapisë antivirale, për një periudhë prej disa javësh. Raporti i ndryshimit të barabartë në ngarkesën virale dhe përfitimit të trajtimit është analizuar në të paktën 6 studime të mëdha të randomizuara, të kontrolluara (ACTG 116A, 116B / 117, dhe 175, VA CS 298, Upjohn 017 dhe 021 dhe Delta 1). Këto studime kanë zbuluar se:

- ✓ Rënia e HIV-1 ARN në plazmë jep një reduktim të ndjeshëm të rrezikut për përparimin e sëmundjes.
- ✓ Reduktimi i rrezikut për progresion të sëmundjes ose vdekje është i pavarur nga rritja e numrit të CD4 që rezulton nga trajtimi.
- ✓ Një reduktim dy herë më pak në plazmë I HIV-1 RNA ($0.3 \log_{10}$) redukton riskun për progresion të sëmundjes dhe vdekje afërsisht deri në 30% (117).
- ✓ Një reduktim 4 herë më pak ($0.6 \log_{10}$) redukton riskun deri në 55% (118).
- ✓ Një reduktim i 10 fishtë ($1 \log_{10}$) redukton riskun deri në 65% (119).

10.0 Ndjekja

Pacientët kanë nevojë për monitorim të afërt për shkak të demencës progresive, polifarmacisë së pashmangshme me nivele ndoshta toksike të barnave (në veçanti, nivelet e barnave të lira) dhe zhvillimit të mundshëm të konvulsioneve dhe psikozës. Pacientët mund të bëhen të paaftë për vetëkujdes dhe të kërkojnë kujdes spitalor. Nivelet e ARN-së së HIV-it dhe numri i qelizave T CD4+ duhet të vlerësohen periodikisht për të monitoruar përgjigjen klinike dhe rezistencën ndaj trajtimit. Nivelet serike të ARN-së së HIV-it në përgjithësi pasqyrojnë nivelet e LCS deri në fund të sëmundjes kur mund të jenë të pranishëm shtame të ndryshme të HIV-it (120). Testimi neuropsikologjik duhet të kryhet në intervale të rregullta për të monitoruar përmirësimin dhe përgjigjet ndaj terapisë. MRI serike mund të tregojë ulje të atrofisë së trurit dhe përmirësim në ndryshimet e lëndës së bardhë kur pacientët i përgjigjen HAART. HAART duhet të vazhdojë pafundësisht në të gjitha rastet. Në varësi të severitetit dhe manifestimeve, pacientët mund të kenë nevojë për vendosje në shtëpi pleqsh dhe kujdes spitalor. Pacientët me demencë të rëndë janë në rrezik për dëmtime nga presioni. Tiparet psikotike mund të kërkojnë konsultim psikiatrik. Ndërsa konvulsionet janë të rralla, menaxhimi i tyre është i vështirë, sepse disa barna kundër konvulsioneve ndikojnë në nivelet në gjak të barnave antiretrovirale.

11.0 Kompetenca e pacientit dhe vendimmarrja

Pacientët duhet të inkurajohen të përgatisin një testament të gjallë ose të caktojnë autorizim në fillim të procesit të sëmundjes së tyre. Çështjet e kompetencës për të marrë vendime mjekësore duhet të adresohen. Pacientët mund të refuzojnë trajtimet e propozuara. E drejta e një personi për autonomi nuk mund të kundërshtohet, me kusht që ata të kenë kompetencën për të kuptuar rreziqet dhe përfitimet e trajtimit të ofruar. Kompetenca për të marrë pëlqimin për trajtimin mjekësor përkufizohet si "kapaciteti mendor i nevojshëm për të kuptuar rreziqet dhe përfitimet e një trajtimi mjekësor të propozuar dhe alternativat e tij". Përjashtimi i vetëm nga kjo situatë do të ishte urgjenca mjekësore në të cilën spitali ose mjeku mund të marrin pëlqimin nga një zëvendësues, një anëtar i ngushtë i familjes ose një bashkëshort. Konsultimet e bioetikës mund të jenë të dobishme. Vetëm një ekip profesionistësh të shëndetit mendor, të caktuar nga shteti ose oficer mund të autorizojë shtrimin në spital të pavullnetshëm. Brenda 72 orëve, pacienti duhet të vlerësohet për aftësinë mendore dhe paaftësinë e rëndë. Paaftësia e rëndë përcaktohet nga aftësia e personit për të siguruar ushqim bazë, veshje dhe strehim për veten e tij. Nëse pacienti përcaktohet se është me aftësi të kufizuara të rënda, ndalimi mund të zgjatet për 14 ditë dhe mund t'i kërkohej gjykatës eprore për caktimin e një kujdestari. Demenca e lidhur me HIV mund të rrezikojë aftësinë e pacientit për të drejtuar në mënyrë të sigurt një automjet. Në raste të tilla, klinici ka për detyrë të këshillojë si pacientin ashtu edhe Departamentin e Mjeteve Motorike se është e pasigurt për pacientin për të drejtuar makinën. Disa pacientë mund të kenë humbje të rënda shqisore të lidhura

me neuropatinë periferike të lidhur me HIV dhe kështu mund të jenë të pasigurt për të drejtuar mjetin (121).

Kujdesi për pacientët me demencën AIDS (ADC) realizohet më së miri me një qasje në ekip, duke u mbështetur në ekspertizën e specialistëve të fushave të ndryshme. Një specialist me ekspertizë në HIV (një mjek i sëmundjeve infektive ose mjek i përgjithshëm) duhet të mbikëqyrë regjimin antiretroviral. Ashtu si të gjithë pacientët me sëmundjen HIV, pacientët me HAND kërkojnë një regjim HAART që është efektiv klinikisht, virologjikisht dhe imunologjikisht. Shpesh tregohen konsultime psikiatrike dhe/ose psikologjike, pasi pacientët me ADC zakonisht shfaqin axhitim, ankth, lodhje, depresion dhe manifestime të tjera psikiatrike. Psikoterapia mund të jetë e dobishme për pacientët me demencë të lehtë deri në mesatare për t'i ndihmuar ata të kuptojnë dhe të përshtaten me këtë dëmtim të ri funksional. Ndërsa popullata e pacientëve me HIV plaket, demenca është një rrezik, sepse shfaqet vonë në jetë; Pacientët e moshuar me HIV mund të zhvillojnë sëmundjen e Parkinsonit, demencën frontotemporale, demencën me trupat Leëy ose sëmundjen Alzheimer që nuk ka lidhje me HIV. Një ndjekje neurologjike nga një neurolog i specializuar në çrregullimet neuro-biheviorale mund të ndihmojë në përcaktimin e etiologjisë së dëmtimit konjitiv. Terapisti fizik dhe terapeuti profesionist luan secili një rol jetësor në përpjekjen për të maksimizuar kapacitetin funksional të pacientit.

12.0 Menaxhimi i pacientëve të infektuar me HIV në depresion

Me futjen në përdorim të SSRI-ve, mjekët internistë dhe specialistët e HIV-it kanë gjetur se trajtimi i depresionit është shumë më i lehtë sesa trajtimi me TCA, sepse skemat e dozimit janë më pak të komplikuar. Veçanërisht për pacientët me HIV në fazën e fundit, menaxhimi i mjekimit nga mjeku primar e bën këtë trajtim shumë më të aksesueshëm, si financiarisht ashtu edhe për sa i përket numrit të vizitave të mjeku.

Për pacientët me depresion të lehtë deri në mesatar, të cilët mohojnë idetë për vetëvrasje pas pyetjeve të drejtpërdrejta dhe nuk kanë histori të tentativave për vetëvrasje, specialistët e HIV-it mund të konsiderojnë të përshkruajnë vetë barna kundër depresionit, pa marrë mendimin e një psikiatri. Sidoqoftë, duhet të keni parasysh 3 konsiderata. Së pari, me përjashtim të psikostimulantëve, barnat kundër depresionit mund të kërkojnë një kohë të gjatë për të dhënë efekt klinik edhe pse efektet anësore mund të shfaqen më shpejt. Pacientët e mësuar me ndryshime të menjëhershme pas marrjes së benzodiazepinave ose qetësuesve duhet të udhëzohen se mund të kalojnë 4 deri në 6 javë përpara se të shfaqet një efekt i qartë i humorit. Së dyti, pacientët duhet të këshillohen për efektet anësore më të zakonshme (të përziera, diarre, stimulim i tepërt, dhimbje koke) dhe të sigurohen se këto ngjarje janë rrallë serioze nga pikëpamja mjekësore dhe zakonisht janë kalimtare, ose mund të kthehen duke reduktuar ose ndërprerë mjekimin. Së treti,

mjeku që jep recetën duhet të inkurajojë dhe qetësojë pacientin çdo javë gjatë muajit të parë të trajtimit me antidepressivë, përpara se efektet klinike të jenë të dukshme.

Në përgjithësi, ne preferojmë SSRI për shumicën e pacientëve të infektuar me HIV në çdo fazë të imunosupresionit, pavarësisht nga shumica e medikamenteve shoqëruese për HIV. Në pacientët me diarre kronike, megjithatë, TCA-të ka të ngjarë të tolerohen më mirë për shkak të efekteve të tyre anësore konstipuese antikolinergjike. Për pacientët që tashmë po marrin amitriptilinë në doza subklinike (25-75 mg/ditë) për neuropatinë periferike dhe të cilëve nuk u duken shqetësuese efektetsedative, mund të jetë e përshtatshme që fillimisht të provohet të rritet doza në një nivel terapeutik (shpesh 200-300 mg/ ditë).

13.0 Medikamentet psikotrope dhe frenuesit e proteazës

Klasa e re e agjentëve antiretroviralë të quajtur frenuesit e proteazës mund të jetë në mënyrë dramatike efektive në reduktimin e ngarkesës virale të HIV dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore dhe klinike, të paktën në afat të shkurtër (122). Saquinavir, ritonavir, indinavir dhe nelfinavir metabolizohen nëpërmjet citokromit P450 të sistemit të oksidazës, kryesisht izoforma 3A3/4, ku izoforma 2D6 është një rrugë metabolike dytësore. Meqenëse këto rrugë metabolike janë të përbashkëta nga shumë barna psikotrope, përdorimi i njëkohshëm i të dy klasave të barnave mund të shkaktojë probleme të rëndësishme për njërën ose tjetrën duke alteruar shkallën e klirensit të tij. Në disa raste, frenuesi i proteazës mund të ngadalësojë metabolizmin dhe të rrisë nivelet në gjak të barit psikotrop (si në rastin e ritonavirit dhe benzodiazepinave). Në të tjera, bari psikotrop mund të rrisë nivelin serik të frenuesit të proteazës, duke nxitur ose përkeqësuar kështu efektet anësore problematike (si në rastin e indinavitit dhe nefazadonit) (123).

Deri më tani, të dhënat në lidhje me ndërveprimet e barnave mungojnë. Mbi një bazë të supozuar, prodhuesi i ritonavir ka listuar të gjitha benzodiazepinat dhe bupropionin si të kundërrindikuar, dhe SSRI-të, antikonvulsantët, shumicën e antipsikotikëve dhe shumicën e TCA-ve si relativisht të kundërrindikuara. Meqenëse frenuesit e proteazës konsiderohen si potencialisht shpëtimtarë, shumica e ofruesve të kujdesit parësor ka të ngjarë të shmangin barin psikotrop dhe jo frenuesin e proteazës, megjithëse asnjë studim zyrtar nuk e ka treguar këtë të nevojshme. Pasoja mund të jetë dështimi për të trajtuar çrregullime të rëndësishme psikiatrike me medikamente të njohura efektive. Derisa të kryhen më shumë kërkime, mjekët duhet të konsiderojnë përdorimin e njëkohshëm të antidepressantëve dhe frenuesve të proteazës, me një mbikëqyrje më të kujdesshme të efekteve dhe efekteve anësore të të dyjave (124).

14.0 Prognoza

Prognoza e çrregullimit neurokonjitiv të lidhur me HIV (HAND) varet nga ashpërsia e tij. Dekursi i pritshëm i dëmtimit neurokonjitiv asimptomatik (ANI) dhe çrregullimit minor neurokonjitiv (MND) nuk njihet mirë, por duke u ekstrapoluar nga Studimi Multicentrik Kohort i AIDS-it, i cili zbuloi se pacientët me HIV nuk kishin më shumë rënie në testet neuropsikometrike sesa grupet e kontrollit të përputhshme me moshën. sugjeron që përkeqësimi konjitiv në pacientët me HAND nuk është i përhapur. Studimi CHARTER, në mënyrë të ngjashme, zbuloi se shumica e pacientëve (61%) mbetën stabilë gjatë një periudhe 42-mujore, ndërsa 16% u përmirësuan dhe 22% u përkeqësuan. Pacientët që patën progresion klinik kishin më shumë gjasa të kishin sëmundje të rënda shoqëruese si përdorimi i drogës dhe hepatiti C, si dhe një shkallë më të lartë të dështimit terapeutik me HAART dhe numër më të ulët të CD4 (125). Demenca e lidhur me HIV (HAD) shoqërohet me një prognozë shumë më të keqe dhe zakonisht shoqërohet me dëmtim progresiv të vëmendjes dhe përqendrimit, ngadalësim motorik dhe ndryshim të sjelljes deri në vdekje brenda 1 viti nga shfaqja. Pacientët e prekur rëndë dhe që plotësojnë kriteret për HAD bazuar në vlerësimin neuropsikologjik, por që nuk shfaqin të dhëna për progression të sëmundjes, mendohet se kanë një prognozë më të mirë (126).

15.0 Edukimi i pacientit

Edukoni pacientin qysh në fazë të hershme të sëmundjes dhe diskutoni implikimet e mundshme mjeko- ligjore të demencës. Pacienti duhet të inkurajohet për të përgatitur një testament të gjallë dhe për të caktuar autorizim. Edukoni pacientët dhe familjet për reziqet e vazhdueshme të transmetimit të HIV.

Edukimi i anëtarëve të familjes, miqve dhe kujdestarëve të një pacienti me çrregullim neurokonjitiv të lidhur me HIV (HAND) është i një rëndësie të madhe. Demenca HIV është një problem i shumëanshëm dhe kujdestarët duhet të njohin komplikacionet, duke përfshirë edhe ato psikiatrike. Shpesh, miqtë dhe familja kanë nevojë për këshillim dhe mbështetje për t'u marrë me këtë gjendje kronike dhe të vështirë.

Çrregullimet klinike depresive ndodhin shumë më rrallë në pacientët me HIV, në çdo fazë sëmundjeje, sesa besohet në fillim të epidemisë. Kur ndodh, depresioni klinik në kontekstin e sëmundjes nga HIV i përgjigjet trajtimit antidepressiv në të njëjtin ritëm si depresioni klinik te pacientët e shëndetshëm mjekësor - një gjetje inkurajuese, pasi trajtimi i depresionit është një nga historitë e suksesit të psikiatrisë. Nuk ka asnjë provë që barnat kundër depresionit janë në ndonjë mënyrë të dëmshme për sistemin imunitar. Prandaj, ne i nxisim specialistët e HIV-it që të jenë vigjilentë ndaj shenjave dhe simptomave të depresionit dhe të marrin në konsideratë trajtimin, ose të paktën referimin, kur simptomat vërehen.

II METODOLOGJIA

2.1 Qëllimi

Vlerësimi e prevalencës së depresionit dhe çrregullimeve konjitive tek personat me infeksionin HIV/AIDS

2.2 Objektivat

- Vlerësimi i prevalencës së depresionit
- Vlerësimi i prevalencës së çrregullimeve neurokonjitive
- Vlerësimi i shoqërimit të depresionit me çrregullimet neurokonjitive
- Vlerësimi i shoqërimit të depresionit me faktorët sociodemografike dhe klinike
- Përcaktimi i faktorëve prediktore të riskut për depresion

2.3 Materiali dhe Metoda

Tipi i studimit: Ky është një studim cross-sectional

Vendi dhe periudha e kryerjes: Studimi është kryer pranë Klinikës Ambulatore për HIV/AIDS, Shërbimit Infektiv dhe Shërbimit të Dermatologjisë të QSUT. Studimi përfshin një periudhe kohore 2010-2015.

Kriteret e përfshirjes në studim

Në studim janë përfshirë të gjithë rastet e pacientëve adulte mbi 18 vjeç të diagnostikuar me infeksion HIV/AIDS të rregjistruar dhe ndjekur pranë klinikës ambulatore dhe Shërbimit Infektiv të QSUT.

Klinika ambulatore për HIV/AIDS pranë Shërbimit Infektiv të QSUT është e vetmja qendër kombëtare e kujdesit terciar në Shqipëri në të cilën trajtohen pacientët me infeksion HIV/AIDS nga i gjithë vendi, është qendër reference për të gjithë spitalet rajonale të vendit dhe si e tillë është përfaqësuese në shkallë vendi për të dhënat e menaxhimit dhe kujdesit për të sëmurët me infeksion HIV/AIDS. Për këtë arsye nuk ishte e nevojshme përcaktimi i kampionit të studimit për të arritur një përmasë kampioni.

Në studim janë përdorur dy pyetësorë (127):

- Beck Depression Inventory II (BDI-II)
- International HIV Dementia Scale (IHDS)

Beck Depression Inventory II (BDI-II) u përdor për të vlerësuar prevalencën dhe ashpërsinë e simptomave depressive. BDI-II ka treguar vlefshmëri dhe besueshmëri të lartë në matjen e simptomave të depresionit. Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin 21 pyetje nga 0 në 3 sipas mënyrës se si ishin ndjerë gjatë 2 javëve të mëparshme. BDI-II fokusohet si në simptomat njohëse-afektive të depresionit, të tilla si pesimizmi dhe vetëvlerësimi i ulët, dhe simptomat somatike të depresionit si humbja e peshës.

Një rezultat prej 14 ose më shumë pikësh pranohet gjerësisht si një pikë cut-off që tregon depresionin në BDI-II.

Rezultatet sipas shkallëve janë:

- 0–13, pa depression ose depression minimal;
- 14–19, depression i lehtë;
- 20–28, depression i moderuar;

dhe 29-63, depresioni madhor ose i rëndë.

IHDS u krijua për t'u përdorur në kontekst ndërkombëtar, me burime të kufizuara si një mjet depistimi në kushte të ndryshme kulturore, gjuhësore dhe arsimore.

Shkalla vlerëson

kujtesën, shpejtësinë motorike dhe funksionimin psikomotor. Mund të inkorporohet lehtësisht brenda një vizite klinike dhe nuk kërkon trajnim specifik.

Në studim janë vlerësuar variablat sociodemografike të më poshtëm:

- Gjinia
- Mosha
- Grupmosha
- Gjendja civile
- Niveli arsimor
- Vendbanimi
- Punësimi
- Nr. i fëmijëve
- Kanë shtëpi
- Fëmijë me HIV

Gjithashtu janë vlerësuar edhe variablat klinike të mëposhtëm:

- P. alkooli
- P. drogë
- Gj. shëndetësore
- Stadi klinik
- Stadi sëmundjes
- IO të kaluara
- Niveli CD4 e fundit
- Ngarkesa virale
- Aderenca ndaj TAR

2.4 Metodologjia e analizës statistikore

Të dhenat u analizuan me programin statistikor SPSS (Statistical Package for Social Sciences) versioni 25. Është paraqitur statistika deskriptive e variablave të vazhduar të cilët janë përmbledhur si mesatare dhe deviacion standard.

Variablat kategorikë janë paraqitur si frekuencë absolute dhe përqindje.

Është përdorur testi hi-katror dhe Fisher's exact test për krahasimin e proporcioneve ndërmjet variablave kategorikë.

Është përdorur testi i studentit t dhe për krahasimin e mesatare të variablave të vazhduar.

Është përdorur metoda e regresionit logjistik multivariat që kontrollon për të gjithë konfonduesit e mundshëm, për vlerësimin e faktorëve të pavarur parashikues të riskut për depresion.

Janë raportuar OR (odds ratio) dhe intervali i besimit 95%CI.

Sinjifikanca statistikore është përcaktuar për $p \leq 0.05$. Testet statistikore janë të dyanshme.

III REZULTATE

Tabela 3. 1 Karakteristikat sociodemografike të pacientëve (N=106)

Variablat	N	%	P
Gjinia			<0.01
Femra	35	33.0	
Meshkuj	71	67.0	
Mosha, M (SD)	40.6 (±9.6)	25-59	
Grupmosha			<0.01
≤30	24	22.6	
31-40	29	27.4	
41-50	41	38.7	
>50	12	11.3	
Gjendja civile			<0.01
Beqar	20	18.9	
Martuar	71	67.0	
Divorcuar	5	4.7	
I ve	10	9.4	
Niveli arsimor			<0.01
Pa shkollë	18	17.0	
8-vjeçare	47	44.3	
E mesme	24	22.6	
E lartë	18	17.0	
Vendbanimi			<0.01
Urban	76	71.7	
Rural	30	28.3	
Nr. i fëmijëve			<0.01
0	13	12.3	
1	46	43.4	
2	20	18.9	
3	20	18.9	
4	7	6.6	
Kanë shtëpi			<0.01
Jo	17	16.0	
Po	89	84.0	
Punësimi			<0.01
Jo	76	71.7	
Po	30	28.3	
Fëmije me HIV			<0.01
Jo	95	89.6	
Po	11	10.4	




Figura 3. 1 Shpërndarja e rasteve sipas gjinisë

Në studim morën pjesë 106 pacientë nga të cilët 33% femra dhe 67% meshkuj, ($p < 0.01$).




Figura 3. 2 Histogrami i moshës së pacientëve

Mosha mesatare e pacientëve është 40.6 (± 9.6) vjeç që varion nga 25-59 vjeç.




Figura 3. 3 Krahasimi i moshës sipas gjinisë

Mosha mesatare e femrave është 36.5 (9.5) vjeç ndërsa e meshkujve është më e lartë 42.7 (9.4) vjeç, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre ($p=0.03$).




Figura 3. 4 Shpërndarja e rasteve sipas grupmoshës

Në studim mbizotëron grupmosha 41-50 vjeç, me ndryshim sinjifikant me grupmoshat e tjera.

Në shpërndarjen sipas grupmoshës u gjet që 22.6% e pacientëve janë ≤30 vjeç, ndjekur nga grupmosha 31-40 vjeç me 27.4% të rasteve, grupmosha 41-50 vjeç me 38.7% të rasteve dhe grupmosha >50 vjeç me 11.3% të rasteve ($p<0.01$).




Figura 3. 5 Shpërndarja e rasteve sipas gjendjes civile nivelit arsimor dhe vendbanimit

Në lidhje me gjendjen civile të pacientëve mbizotërojnë të martuarit (67%) ndjekur nga beqarët (18.9%), pacientët e ve (9.4%) dhe të divorcuarit (4.7%), ($p < 0.01$).

Mbizotërojnë pacientët me shkollë 8-vjeçare (44.3%), 17% e tyre janë pa shkollë 22.6% janë me shkollë të mesme dhe 17% e tyre me arsim të lartë ($p < 0.01$).

Mbizotëron vendbanimi urban në 71.7% të rasteve me ndryshim sinjifikanë me pacientët në zonën rurale (28.3%) ($p < 0.01$).




Figura 3. 6 Shpërndarja e rasteve sipas numrit të fëmijëve

Shumica e pacientëve në studim janë me një fëmijë.

Pa fëmijë janë 12.3% e pacientëve, me një fëmijë janë 43.4% e tyre, me nga dy fëmijë dhe tre fëmijë janë përkatësisht nga 18.9% e pacientëve dhe me katër fëmijë janë 6.6% e tyre ($p < 0.01$).




Figura 3. 7 Shpërndarja e rasteve sipas statusit të shtëpisë

Shumica e pacientëve (84%) kanë shtëpi ndërsa 16% e tyre nuk kanë ($p < 0.01$).




Figura 3. 8 Shpërndarja e rasteve sipas punësimit

Të punësuar janë vetëm 28.3% e pacientëve ndërsa 71.7% e tyre nuk janë të punësuar ($p < 0.01$).




Figura 3. 9 Shpërndarja e rasteve sipas numrit të fëmijëve me HIV
Fëmijë me HIV kanë 10.4% e pacientëve.

Tabela 3. 2 Sjellja e pacientëve dhe karakteristikat klinike

Variablat	N	%	P
Përdorim alkooli			<0.01
Jo	97	91.5	
Po	9	8.5	
Përdorim droge			<0.01
Jo	101	95.3	
Po	5	4.7	
Vite dg.HIV, M (SD)	8.4 (3.6)	2-18	
Gj. shëndetësore			0.4
Mirë	57	53.8	
Keq	49	46.2	
Stadi klinik			0.4
Asimptomatik	57	53.8	
Simptomatik	49	46.2	
Stadi sëmundjes			0.3
Stadi A	29	27.4	
Stadi B	36	34.0	
Stadi C	41	38.7	
IO të kaluara			0.03
Jo	42	39.6	
Po	64	60.4	
Niveli CD4 e fundit			<0.01
<200	44	41.5	
200-500	46	43.4	
>500	16	15.1	
Ngarkesa virale			<0.01
≤1000	78	73.6	
>1000	28	26.4	
Vite TAR, M (SD)	5.8 (2.9)	3-9	
Aderenca ndaj TAR			<0.01
E mirë	83	78.3	
Jo e mirë	23	21.7	




Figura 3. 10 Frekuenca e përdorimit të alkoolit dhe drogës

Alkool përdorin (8.5%) e pacientëve ndërsa drogë referojnë që përdorin 4.7% e tyre.




Figura 3. 11 Gjendja shëndetësore e pacientëve

Koha mesatare e diagnostikimit me HIV të pacientëve është 8.4 (3.6) vjet që varion nga 2 deri në 18 vjet.

Në 46.2% të pacientëve gjendja shëndetësore është e keqe ndërsa në 53.8% të tyre e mirë (p=0.4).




Figura 3. 12 Stadi klinik sipas pranisë së simptomave

Simptomatike janë 46.2% e pacientëve ndërsa asimptomatikë janë 53.8% e tyre (p=0.4)




Figura 3. 13 Stadi i sëmundjes

27.4% e pacientëve janë në stadin A, 34% në stadin B dhe mbizotëron stadi C në 38.7% të pacientëve, pa ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre (p=0.3).

Në studim u gjet prevalence e lartë e infeksioneve oportunistike të kaluara, nivel i ulët i CD4 në matjen e fundit dhe ngarkesë e lartë virale.




Figura 3. 14 Frekuenca e infeksioneve oportunistike të kaluara

Infeksione oportunistike kanë kaluar shumica e pacientëve (60.4) ndërsa 39.6% e tyre nuk ka kaluar, me ndryshim sinjifikant ($p=0.03$).




Figura 3. 15 Niveli i CD4 në matjen e fundit

Niveli i CD4 në matjen e fundit ishte < 200 në 41.5% të pacientëve, 200-500 në 43.4% të tyre dhe > 500 në 15.1% të pacientëve, me ndryshim sinjifikant ($p<0.01$).




Figura 3. 16 Aderenca ndaj TAR

Koha mesatare që pacientët marrin TAR është 5.8 (2.9) vjet që varion nga 3-9 vjet. Aderenca ndaj TAR ishe e mirë në 78.3% të rasteve dhe jo e mirë në 21.7% të tyre, me ndryshim sinjifikant ($p < 0.01$)

Tabela 3. 3 Prevalenca e depresionit dhe çrregullimeve neurokonjitive

	Depresion	Çrregullime neurokonjitive	Depresion dhe Ç. Neurokonjitive
N	29	22	12
%	27.4	20.8	11.3
95%CI	19.18 - 36.91	13.52 - 29.76	5.97 - 18.91




Figura 3. 17 Prevalenca e depresionit dhe çrregullimeve neurokonjitive

Prevalencë e depresioni në studim rezultoi 27.4% (95% CI 19.18 - 36.91) e çrregullimeve neurokonjitive 20.8% (95% CI 13.52 - 29.76) dhe prevalenca e depresionit bashkë me çrregullime neurokonjitive 11.3% (95% CI 5.97 - 18.91).

Tabela 3. 4 Niveli i depresionit për totalin e pacientëve dhe sipas gjinisë

Niveli i Depresionit	Total (n=106)	Femra (n=35)	Meshkuj (n=77)
Jo/minimal	77 (72.6)	21 (60.0)	62 (80.5)
I lehtë	18 (17.0)	11 (31.4)	7 (9.1)
Mesatar	9 (8.5)	2 (5.7)	7 (9.1)
I rëndë	2 (1.9)	1 (2.9)	1 (1.3)

Pa depresion rezultuan 72.6% e pacientëve, me depresion të lehtë 17% e tyre, me depresion mesatar 8.5% dhe me depresion të rëndë 1.9% e tyre ($p < 0.01$).




Figura 3. 18 Niveli i depresionit për totalin e pacientëve




Figura 3. 19 Niveli i depresionit sipas gjinisë

Në studim u gjet një nivel më i lartë i depresionit tek femrat me ndryshim sinjikanant krahasuar me meshkujt ($p=0.02$).

Pa depresion janë 60% e femrave dhe 80.5% e meshkujve;

Me depresion të lehtë janë 31.4% e femrave dhe 9.1% e meshkujve dhe me depresion të rëndë janë 2.9% e femrave dhe 1.3% e meshkujve, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre

Tabela 3. 5 Shoqërimi i depresionit me çrregullimet neurokonjitive

Niveli i Depresionit	Total (n=106)	Çrregullime neurokonjitive	
		PO (n=22)	JO (n=84)
Jo/minimal	77 (72.6)	10 (45.5)	67 (79.8)
I lehtë	18 (17.0)	7 (31.8)	11 (13.1)
Mesatar	9 (8.5)	3 (13.6)	6 (7.1)
I rëndë	2 (1.9)	2 (9.1)	0




Figura 3. 20 Shoqërimi i depresionit me çrregullimet neurokonjitive

Në studim u gjet shoqërim sinjifikant i depresionit dhe çrregullimeve neurokonjitive ($p<0.01$).

31.8% e pacientëve me çrregullime neurokonjitive kanë edhe depresion të shkallës së lehtë, 13.6% e tyre kanë depresion të shkallës mesatare dhe 9.1% e tyre kanë depresion të shkallës së rëndë ($p<0.01$).

Tabela 3. 6 Prevalenca e depresionit sipas karakteristikave sociodemografike

Variablat	Depresion		P
	Po (n=29) n (%)	Jo (n=77) n (%)	
Gjinia			0.04
Femra	14 (40.0)	21 (60.0)	
Meshkuj	15 (21.0)	56 (78.9)	
Mosha, M (SD)			
Grupmosha			
≤30	2 (8.3)	22 (79.2)	0.03
31-40	7 (24.1)	19 (72.4)	
41-50	17 (41.5)	25 (68.3)	
>50	3 (25.0)	61 (75.0)	
Gjendja civile			0.1
Beqar	8 (40.0)	12 (60.0)	
Martuar	15 (21.1)	56 (78.9)	
Divorcuar	3 (60.0)	2 (40.0)	
I ve	3 (30.0)	7 (70.0)	
Niveli arsimor			0.5
Pa shkollë	5 (27.8)	13 (72.2)	
8-vjeçare	10 (21.3)	37 (78.7)	
E mesme	9 (37.5)	15 (62.5)	
E lartë	5 (27.8)	13 (72.2)	
Vendbanimi			0.9
Urban	21 (27.6)	55 (72.4)	
Rural	8 (26.7)	22 (73.3)	
Nr. i fëmijëve			< 0.01
0	2 (15.4)	11 (84.6)	
1	6 (13.0)	40 (87.0)	
2	6 (30.0)	14 (70.0)	
3	4 (57.1)	3 (42.9)	
4	11 (55.0)	9 (45.0)	
Kanë shtëpi			0.04
Jo	8 (47.1)	9 (52.9)	
Po	21 (23.6)	68 (76.4)	
Punësimi			0.9
Jo	26 (27.4)	69 (72.6)	
Po	3 (27.3)	8 (72.7)	
Fëmijë me HIV			0.03
Jo	23 (24.2)	72 (75.8)	
Po	6 (79.3)	5 (20.7)	




Figura 3. 21 Shoqërimi i depresionit me karakteristikat sociodemografike

-Shoqërimi i depresionit me karakteristikat sociodemografike

Në studim u gjet shoqërim sinjifikant i depresionit sipas gjinisë ($p=0.04$), grupmoshës ($p=0.03$), numrit të fëmijëve ($p<0.01$), statusit të shtëpisë ($p=0.04$) dhe fëmijëve me HIV ($p=0.03$).

Me depression janë 40% e femrave dhe 21% e meshkujve, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre ($p=0.04$)

Depresioni mbizotëron në grupmoshën 41-50 vjeç, me ndryshim sinjifikant me grupmoshat e tjera. Në grupmoshën ≤30 vjeç me depression janë 8.3% e tyre, në grupmoshën 31-40 vjeç janë 24.1% e tyre dhe në grupmoshën >50 vjeç janë 25% e pacientëve.

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant sipas statusit civil. Me depression janë 40% e beqarëve, 21.1% e të martuarve, 60% e të divorcuarve dhe 30% e pacientëve të ve ($p=0.1$).

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant sipas nivelit arsimor. Me depression janë 27.8% e pacientëve pa shkollë, 21.3% e pacientëve me 8 vjeçare, 37.5% e pacientëve me shkollë të mesme dhe 27.8% e pacientëve me shkollë të lartë (p=0.5).

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant sipas vendbanimit. Me depression u gjetën 27.6% e pacientëve në zonën urbane dhe 26.7% e pacientëve në zonën rurale (p=0.9).




Figura 3. 22 Shoqërimi i depresionit me karakteristikat sociodemografike

Në studim u gjet një trend sinjifikant në rritje të prevalencës së depresionit me rritjen e numrit të fëmijëve. Me depression u gjetën 15.4% e pacientëve që nuk kanë fëmijë, 13% e pacientëve që kanë një fëmijë, 30% e pacientëve që kanë dy fëmijë, 27.1% e pacientëve që kanë 3 fëmijë dhe 55% e pacientëve që kanë 4 fëmijë (p<0.01).

Depression manifestuan 47.1% e pacientëve që nuk kanë shtëpi krahasuar me 23.6% të cilët kanë shtëpi, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre (p=0.04).

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant sipas statusit të punësimit. Me depression u gjetën 27.4% e të papunëve dhe 27.3% e të punësuarve (p=0.9).

Pacientët që kanë fëmijë me HIV kanë nivel më të lartë të depresionit (79.3%) krahasuar me pacientet që nuk kanë fëmijë me HIV (24.2%) me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre (p=0.03).

Tabela 3. 7 Prevalenca e depresionit sipas karakteristikave klinike dhe të sjelljes

Variablat	Depresion		P
	Po (n=29) n (%)	Jo (n=77) n (%)	
Përdorim alkooli			<0.01
Jo	23 (23.7)	74 (76.3)	
Po	6 (66.7)	3 (33.3)	
Përdorim droge			<0.01
Jo	25 (24.8)	76 (75.2)	
Po	4 (80.0)	1 (20.0)	
Gj. shëndetësore			0.02
Keq	21 (36.8)	36 (63.2)	
Mirë	8 (16.3)	41 (83.7)	
Stadi klinik			0.09
Asimptomatik	9 (19.1)	38 (80.9)	
Simptomatik	20 (33.9)	39 (66.1)	
Stadi sëmundjes			0.1
Stadi A	4 (13.8)	25 (86.2)	
Stadi B	11 (30.6)	25 (69.4)	
Stadi C	14 (34.1)	27 (65.9)	
IO të kaluara			<0.01
Jo	5 (11.9)	37 (88.1)	
Po	24 (37.5)	40 (62.5)	
Niveli CD4 e fundit			<0.01
<200	16 (36.4)	28 (63.6)	
200-500	9 (19.6)	37 (80.4)	
>500	4 (25.0)	12 (75.0)	
Ngarkesa virale			<0.01
≤1000	9 (11.5)	69 (88.5)	
>1000	20 (71.4)	8 (28.6)	
Aderenca ndaj TAR			<0.01
E mirë	7 (8.4)	76 (91.6)	
Jo e mirë	22 (95.7)	1 (4.3)	




Figura 3. 23 Shoqërimi i depresionit me karakteristikat klinike

-Shoqërimi i depresionit me karakteristikat klinike

Në studim u gjet shoqërim sinjifikant i depresionit me përdorimin e alkoolit, përdorimin e drogës, gjendjen e keqe shëndetësore, infeksione oportunistike të kaluara, nivelin e fundit të CD4, ngarkesën virale dhe aderencën ndaj TAR.

Nga pacientët me depresion 66.7% e tyre përdorin alkool, ndërsa 23.7% tyre nuk përdorin, me ndryshim sinjifikant, ($p < 0.01$).

Gjithashtu nga pacientët që janë me depresion 80% e tyre përdorin drogën ndërsa 24.8% e tyre jo, me ndryshim sinjifikant, ($p < 0.01$).

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant sipas stadiit klinik dhe stadiit të sëmundjes.

Me depresion janë 33.9% e pacientëve simptomatike dhe 19.1% e pacientëve josimptomatike, pa ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre ($p = 0.09$).




Figura 3. 24 Shoqërimi i depresionit me karakteristikat klinike

Në stadin A janë 13.8% e pacientëve me depression, ndjekur me 30.6% të pacientëve në stadin B dhe 34.1% të pacientëve në stadin C, pa ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre ($p=0.1$).

Shumica e pacientëve që kanë patur infeksione oportunistike të kaluara kanë manifestuar depression (37.5%) krahasuar me 11.9% të pacientëve pa infeksione oportunistike, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre ($p<0.01$).

Në studim u gjet shoqërim sinjifikant i depresionit me uljen e nivelit të Cd4. Me depression u gjetën 36.4% e pacientëve me $CD4 < 200$, 30.6% e pacientëve me $CD4 220-500$ dhe 25% e pacientëve me $CD4 > 500$ ($p<0.01$)

Shumica e pacientëve me ngarkesë virale >1000 kanë shfaqur depression (28.6%) krahasuar me 11.5% të pacientëve me ngarkesë virale ≤ 1000 .

95.7% e pacientëve që nuk kanë adherencë të mirë ndaj TAR kanë shfaqur depression, krahasuar me 8.4% të pacientëve me aderencë të mirë ndaj TAR, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre, ($p<0.01$).

Tabela 3. 8 Faktorët e riskut për depresion. Analiza multivariate

Variablat	OR	95%CI	P
Gjinia/Femra	1.33	0.90-3.76	0.1
Grupmosha			
≤30	1		
31-40	2.1	0.64-12.3	0.6
41-50	3.2	1.11-14.7	0.01
>50	1.54	0.71-10.5	0.5
Gjendja civile			
Beqar	1		
Martuar	0.84	0.53-1.98	0.4
Divorcuar	1.15	0.80-2.21	0.2
I ve	0.77	0.52-2.14	0.7
Niveli arsimor			
Pa shkollë / 8 vjeçare	1		
E mesme	1.10	0.73-3.62	0.6
E lartë	0.96	0.84-2.55	0.3
Vendbanimi/ urban	1.08	0.66-2.14	0.5
Nr. i fëmijëve	1.41	0.81-3.18	0.1
Shtëpia/jo	1.07	0.80-3.81	0.8
Punësimi/jo	1.06	0.56-3.42	0.9
Fëmijë me HIV	1.89	1.09-6.40	0.03
Përdorim alkooli / droge	2.31	1.21-4.56	<0.01
Vite dg.HIV	1.21	0.59-3.47	0.3
Gj. Shendetësore/ e keqe	1.24	0.73-2.12	0.2
Stadi klinik /simptomatik	1.16	0.87-4.33	0.4
Stadi sëmundjes			
Stadi A	1		
Stadi B	1.23	0.75-2.69	0.4
Stadi C	1.29	0.81-2.45	0.2
IO te kaluara	1.18	0.86-3.13	0.6
Niveli CD4 e fundit			
>500	1		
200-500	1.22	0.83-3.37	0.4
<200	1.36	0.75-2.18	0.1
Ngarkesa virale			
≤1000	1		
>1000	2.54	1.17-4.14	0.01
Vite me TAR	1.09	0.77-2.68	0.5
Aderenca ndaj TAR	2.65	1.15-3.22	<0.01




Figura 3. 25 Faktorët e riskut për depression. Analiza multivariate

Në analizën multivariate të regresionit logjistik faktorë sinjifikante dhe të pavarur të riskut për depression rezultuan: grupmosha 1-50 vjeç ($p=0.01$); Fëmijë me HIV ($p=0.03$); Përdorim alkooli / droge ($p<0.01$); Ngarkesa virale >1000 ($p=0.01$) dhe Aderenca jo e mirë ndaj TAR ($p<0.01$).

IV DISKUTIM

HIV/AIDS është bërë një nga barrat kryesore shëndetësore globale. Deri në fund të vitit 2017, kishte 36.9 milionë njerëz që jetonin me HIV (PLWH) në mbarë botën me 1.8 milionë raste të reja të infeksionit dhe 940,000 vdekje (128). Midis tyre, 39% u raportuan se kishin vuajtur nga depresioni (129). Depresioni është një çrregullim i shëndetit mendor që është shumë i përhapur dhe karakterizohet nga humor i ulët, vetëvlerësim i zvogëluar, mendime pesimiste, përqendrim i dobët dhe simptoma biologjike (ajo e oreksit të dobët dhe vështirësive të gjumit) dhe tërheqje e shtuar nga aktivitetet shoqërore. Së bashku me çrregullimin e ankthit, këto probleme psikiatrike mund të rezultojnë në dëmtime kronike të dëmshme dhe madje mund të çojnë në ide vetëvrasëse (130). Sipas raportit të fundit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), ka pasur mbi 300 milionë njerëz që jetojnë me depresion dhe gati 800,000 pacientë kanë vdekur për shkak të vetëvrasjes çdo vit (131). Çrregullimet depressive kanë shkaktuar mbi 50 milionë vjet jetë me aftësi të kufizuara (YLD) në mbarë botën, duke zënë 7.5% të YLD-së totale globale dhe, në këtë mënyrë, konsiderohen si kontribuesi i vetëm më i madh në humbjen jo-fatale të shëndetit (132). Në individët që jetojnë me HIV, depresioni mund të përkeqësojë gjendjet ekzistuese të sëmundjes dhe të çojë në rezultate më të dobëta shëndetësore.

Prevalenca e vlerësuar e çrregullimit depresiv madhor në popullatën e përgjithshme është afërsisht 10% deri në 25% për gratë dhe nga 5% në 12% për burrat. Parashikimet tregojnë se deri në vitin 2020, depresioni i madh do të jetë shkaku i dytë më i madh i paaftësisë dhe vdekjes në mbarë botën (133). Studimet epidemiologjike të depresionit në sëmundjet klinike janë edhe më shqetësuese, pasi depresioni shfaqet shpesh tek pacientët me diabet, (134) pas infarktut akut të miokardit, (135) dhe të individët me kancer (136). Shkalla e prevalencës së depresionit në PLWHA varion midis 20% dhe 79%, në varësi të popullsisë së studiuar, periudhës së hetuar dhe mjeteve të përdorura për të përcaktuar pacientët (137). Vlerësimi i simptomave të depresionit te individët që jetojnë me HIV/AIDS duhet bërë me kujdes dhe duhet të merren parasysh fazat e sëmundjes, sepse disa simptoma fizike dobësuese mund të zbehin treguesit e depresionit (138). Po kështu, duhet t'i kushtohet vëmendje faktit që disa barna antiretrovirale (ARV) mund të shkaktojnë simptoma të ngjashme me ato që gjenden në depresion (139). Ekziston edhe çmenduria e lidhur me HIV që mund të keqdiagnostikohet si depresioni, kështu që ndryshojnë duhet kryer diagnoza diferenciale (140).

Ky studim u krye për vlerësimi e prevalencës së depresionit dhe çrregullimeve konjitive tek personat me infeksionin HIV/AIDS në vendin tonë. Në studim morën pjesë 106 pacientë nga të cilët 33% femra dhe 67% meshkuj.

Mosha mesatare e pacientëve është 40.6 (\pm 9.6) vjeç që varion nga 25-59 vjeç. Mosha mesatare e femrave është 36.5 (9.5) vjeç ndërsa e meshkujve është më e lartë 42.7 (9.4) vjeç, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

Në studim mbizotëron grupmosha 41-50 vjeç, me ndryshim sinjifikant me grupmoshat e tjera. Në shpërndarjen sipas grupmoshës u gjet që 22.6% e pacientëve janë \leq 30 vjeç, ndjekur nga grupmosha 31-40 vjeç me 27.4% të rasteve, grupmosha 41-50 vjeç me 38.7% të rasteve dhe grupmosha $>$ 50 vjeç me 11.3% të rasteve.

Në lidhje me gjendjen civile të pacientëve mbizotërojnë të martuarit (67%) ndjekur nga beqarët (18.9%), pacientët e ve (9.4%) dhe të divorcuarit (4.7%),

Mbizotërojnë pacientët me shkollë 8-vjeçare (44.3%), 17% e tyre janë pa shkollë 22.6% janë me shkollë të mesme dhe 17% e tyre me arsim të lartë.

Mbizotëron vendbanimi urban në 71.7% të rasteve me ndryshim sinjifikant me pacientët në zonën rurale (28.3%). Shumica e pacientëve në studim janë me një fëmijë.

Pa fëmijë janë 12.3% e pacientëve, me një fëmijë janë 43.4% e tyre, me nga dy fëmijë dhe tre fëmijë janë përkatësisht nga 18.9% e pacientëve dhe me katër fëmijë janë 6.6% e tyre.

Shumica e pacientëve (84%) kanë shtëpi ndërsa 16% e tyre nuk kanë ($p < 0.01$).

Të punësuar janë vetëm 28.3% e pacientëve ndërsa 71.7% e tyre nuk janë të punësuar.

Fëmijë me HIV kanë 10.4% e pacientëve. Alkool përdorin (8.5%) e pacientëve ndërsa drogë referojnë që përdorin 4.7% e tyre.

Koha mesatare e diagnostikimit me HIV të pacientëve është 8.4 (3.6) vjet që varion nga 2 deri në 18 vjet. Në 46.2% të pacientëve gjëndja shëndetësore është e keqe ndërsa në 53.8% të tyre e mirë. Simptomatike janë 46.2% e pacientëve ndërsa asimptomatike janë 53.8% e tyre. 27.4% e pacientëve janë në stadin A, 34% në stadin B dhe mbizotëron stadi C në 38.7% të pacientëve, pa ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

Në studim u gjet prevalencë e lartë e infeksioneve oportunistike të kaluara, nivel i ulët i CD4 në matjen e fundit dhe ngarkesë e lartë virale. Infeksione oportunistike kanë kaluar shumica e pacientëve (60.4) ndërsa 39.6% e tyre nuk ka kaluar, me ndryshim sinjifikant.

Niveli i CD4 në matjen e fundit ishte $<$ 200 në 41.5% të pacientëve, 200-500 në 43.4% të tyre dhe $>$ 500 në 15.1% të pacientëve, me ndryshim sinjifikant. Koha mesatare që pacientët marrin TAR është 5.8 (2.9) vjet që varion nga 3-9 vjet.

Aderenca ndaj TAR ishte e mirë në 78.3% të rasteve dhe jo e mirë në 21.7% të tyre, me ndryshim sinjifikant. Prevalenca e depresioni në studim rezultoi 27.4% (95%CI 19.18 - 36.91) e çrregullimeve neurokonjitive 20.8% (95% CI 13.52 - 29.76) dhe prevalenca e depresionit bashkë me çrregullime neurokonjitive 11.3% (95%CI 5.97 - 18.91). Pa depresion rezultuan 72.6% e pacientëve, me depression të lehtë 17% e tyre, me depression mesatar 8.5% dhe me depression të rëndë 1.9%) e tyre. Në studim u gjet një nivel më i lartë i depresionit tek femrat me ndryshim sinjifikant krahasuar me meshkujt. Pa depresion janë 60% e femrave dhe 80.5% e meshkujve; Me depression të lehtë janë 31.4% e femrave dhe 9.1% e meshkujve dhe me depression të rëndë janë 2.9% e femrave dhe 1.3% e meshkujve, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

Në studim u gjet shoqërim sinjifikant i depresionit dhe çrregullimeve neurokonjitive. 31.8% e pacientëve me çrregullime neurokonjitive kanë edhe depresion të shkallës së lehte, 13.6% e tyre kanë depresion të shkallës mesatare dhe 9.1% e tyre kanë depresion të shkallës së rëndë.

-Shoqërimi i depresionit me karakteristikat sociodemografike

Në studim u gjet shoqërim sinjifikant i depresionit sipas gjinisë, grupmoshës, numrit të fëmijëve, statusit të shtëpisë dhe fëmijëve me HIV.

Me depresion janë 40% e femrave dhe 21% e meshkujve, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

Depresioni mbizotëron në grupmoshën 41-50 vjeç, me ndryshim sinjifikant me grupmoshat e tjera. Në grupmoshën ≤ 30 vjeç me depresion janë 8.3% e tyre, në grupmoshën 31-40 vjeç janë 24.1% e tyre dhe në grupmoshën > 50 vjeç janë 25% e pacientëve.

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant sipas statusit civil. Me depresion janë 40% e beqarëve, 21.1% e të martuarve, 60% e të divorcuarve dhe 30% e pacientëve të ve.

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant sipas nivelit arsimor. Me depresion janë 27.8% e pacientëve pa shkollë, 21.3% e pacientëve me 8 vjeçare, 37.5% e pacientëve me shkollë të mesme dhe 27.8% e pacientëve me shkollë të lartë.

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant sipas vendbanimit. Me depresion u gjetën 27.6% e pacientëve në zonën urbane dhe 26.7% e pacientëve në zonën rurale.

Në studim u gjet një trend sinjifikant në rritje të prevalencës së depresionit me rritjen e numrit të fëmijëve. Me depresion u gjetën 15.4% e pacientëve që nuk kanë fëmijë, 13% e pacientëve që kanë një fëmijë, 30% e pacientëve që kanë dy fëmijë, 27.1% e pacientëve që kanë 3 fëmijë dhe 55% e pacientëve që kanë 4 fëmijë.

Depresion manifestuan 47.1% e pacientëve që nuk kanë shtëpi krahasuar me 23.6% të cilët kanë shtëpi, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant sipas statusit të punësimit. Me depresion u gjetën 27.4% e të papunëve dhe 27.3% e të punësuarve.

Pacientët që kanë fëmijë me HIV kanë nivel më të lartë të depresionit (79.3%) krahasuar me pacientët që nuk kanë fëmijë me HIV (24.2%) me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

-Shoqërimi i depresionit me karakteristikat klinike.

